



Bashkia Fier

PLANI I KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA FIER
2019 - 2023





Bashkia Fier

PLANI I KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA FIER
2019 - 2023

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 51, datë 17/05/2019



Plani i Kujdesit Social është hartuar nga Bashkia Fier, në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore dhe shoqërisë civile, me mbështetjen teknike të Fondacionit "Ndihmë për Fëmijët", në kuadër të Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush Të Mos Mbetet Pas", që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikëqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP.



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	7
2. METODOLOGJIA	9
2.1 Qëllimi dhe objektivat e PKS-së	9
2.2 Vlerat dhe Parimet e Planit të Kujdesit Social	10
2.3 Procesi dhe përmbajtja e PKS-së	10
3. PREZANTIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË FIER	9
3.1 Të dhëna demografike	13
3.2 Ekonomia	13
3.3 Punësimi dhe papunësia	15
3.4 Arsimi	17
3.5 Kujdesi Shëndetësor	18
4. ANALIZA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, NJERËZORE DHE FINANCIARE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL	21
4.1 Shërbimet Sociale në Bashkinë Fier	21
4.1.1 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier.	21
4.1.2 Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Fier	21
4.1.3 Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve	22
4.1.4 Njësia për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje	22
4.1.5 Shërbimet ekzistuese të përkujdesit shoqëror	23
4.2 Burimet njerëzore	24
4.3 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale në Bashkinë e Fierit	25
4.4 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesit social në Bashkinë e Fierit	27
5. ANALIZA E NEVOJAVE SOCIALE TË GRUPEVE NË REZIK	29
5.1 Familjet e varfëra	29
5.2 Fëmijët në rrezik	31
5.2.1 Fëmijët e familjeve të varfëra	31
5.2.2 Fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë	31
5.3 Personat me aftësi të kufizuar	33
5.4 Familje të pastreha	35
5.5 Dhuna në familje	36
5.6 Të moshuarit e vetmuar	38
5.7 Komunitetet	38
5.8 Të rinjtë në rrezik	42
5.9 Analiza SWOT, Sfida dhe nevoja për ndërhyrje në të ardhmen	42
5.9.1 Përmirësime në Strukturën e Shërbimit Social	44
5.9.2 Përmirësimi dhe Ngritja e Shërbimeve të Reja të Përkujdesit Shoqëror	44

6. Përcaktimi i vizionit, fushave, qëllimeve dhe objektivave të PKS-së 45

Anekset 51

Aneski 1. Situata e Shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Fier 51

Aneski 2. Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror (për individë ose grupe) 53

Aneski 3. Plani i monitorimit dhe vlerësimit 55

Aneski 4. Kostimi dhe Hendeku Buxhetor 58

SHKURTIMET

GTM	Grupi Teknik Multidisiplinar
ISHPSHS	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale
LSMS	Studimi për Matjen e Standardit të Jetesës
NE	Ndihma Ekonomike
NjBGJDHF	Njësia e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje
NjVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
NPF	Organizata Jo-Fitimprurese Ndihmë për Fëmijët
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKS	Plani i Kujdesit Social
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
SWOT	Analiza e anëve të forta, dobëta, mundësive dhe rreziqeve
UNDP	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

1. HYRJE

Plani i Kujdesit Social për Bashkinë Fier është i përshtatur brenda një kuadri dhe konteksti të planeve ekzistuese të zhvillimit të kësaj bashkie¹. Plani është produkt i një procesi gjithëpërfshirës, i cili pasqyron vizionin e komunitetit dhe siguron një plan afatmesëm për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social, në përputhje me nevojat e individëve, familjeve dhe komunitetit, që jetojnë në territorin e bashkisë. Ai përfshin rolet për të gjithë aktorët që veprojnë në nivel vendor (ku rolin kryesor e ka bashkia), institucionet qendrore, organizatat e shoqërisë civile dhe profesionistët. Plani i Kujdesit Social 2019-2023 përcakton vizionin, qëllimet strategjike dhe objektivat specifike, të cilat do të integrohen në programin e politikave të Bashkisë dhe do të pasqyrojnë nevojat për shërbime sociale të grupeve në nevoje dhe atyre të rrezikuara, me qëllim që të krijohen premisat për një bashkëjetesë sociale ndërmjet grupeve të ndryshme të komunitetit.

Bashkia e Fierit nuk është unike përsa i përket sfidave që paraqesin grupet në rrezik, por ka disa elementë dallues që kërkojnë zgjidhje të përshtatura me problematikën sociale që paraqesin këto grupe. Për këtë arsye në procesin e hartimit të këtij dokumenti janë përfshirë qytetarët, grupet e interesit, shoqëria civile, individë, udhëheqësit e biznesit, të cilët përmes konsultimeve publike, komenteve me shkrim, intervistave dhe të dhënave, kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të PKS-së. Ne e kemi bashkuar këtë kontribut me analiza të bazuara në të dhëna dhe kemi punuar së bashku për të zhvilluar këtë rrugë frymëzuese dhe praktike për pesë vitet e ardhshme.

PKS është një dokument kyç që synon të jetë një dokument “jo i ngurtë”, i cili siguron një drejtim të qartë dhe krijon themelin për vendimet organizative dhe operacionale të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Fier, por nga ana tjetër dokumenti krijon hapësirë për ta rishikuar dhe përmirësuar rregullisht në bazë të rekomandimeve dhe ndryshimeve sociale dhe ekonomike të komunitetit.

Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 24 përcaktohet se: “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtetas në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj.”. Gjithashtu në Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36 “Roli i Bashkisë” përcaktohet se: “njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social, bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore, Bashkia harton planin e kujdesit social vendor”. Këto funksione dhe përgjegjësi të reja, si edhe zgjerimi i territorit dhe popullatës që bashkia duhet të mbulojë me shërbime, nxjerrin në pah edhe nevojën e një procesi gjithëpërfshirës të programimit, planifikimit dhe monitorimit të shërbimeve sociale në nivel vendor.

Plani Social është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale. Ai shoqërohet gjithashtu me Planin e Veprimit (2019-2023) i cili është i ndarë në katër fusha kryesore:

1. **Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve**
2. **Ngritja e kapaciteteve të strukturave dhe burimeve njerëzore**
3. **Zhvillimi i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Fierit**
4. **Zhvillimi i Programeve parandaluese**

¹ Plani i Përgjithshëm Vendor i Territorit (2016)- Bashkia Fier;
Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje, hartuar me mbështetjen e UNDP;
Plani Lokal i Zhvillimit, Pjesëmarrjes e Gjithëpërfshirjes për PAK në Rajonin e Fierit.
Plani Vendor për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Fier, 2019-2022;
Të buxhetojmë për rininë, me rininë, Bashkia Fier, hartuar me mbështetjen e UNFPA, 2018.

2. METODOLOGJIA

2.1 Qëllimi dhe objektivat e PKS-së

Fieri është duke u përballur me një sërë problemesh sociale siç janë: fëmijët në rrezik, dhuna në familje, probleme ekonomike dhe sociale të komuniteteve Rom dhe Egjiptian, të moshuarit e vetmuar, të rinjtë e papunë dhe mungesa e aftësive të nevojshme për t'u integruar në një ekonomi në ndryshim, probleme të strehimit etj.

Nisur nga këto veçanti, qëllimi i PKS-së është të krijojë një vizion kolektiv ku bashkia dhe partnerët e saj, të planifikojnë të ardhmen e shërbimeve sociale, të maksimizojnë burimet për të përballuar nevojat më emergjente për shërbime dhe të adresojnë prioritetet.

Objektivat e PKS-së janë :

- Të përmbushë një nga përgjegjësitë ligjore të qeverisjes vendore që lidhet me sigurimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë;
- Të planifikojë dhe të mobilizojë të gjitha burimet ekzistuese (njerëzore, materiale dhe financiare) dhe të mundësojë përdorimin me efikasitet të tyre (paratë shpenzohen vetëm në ato shërbime që janë të domosdoshme);
- Të rrisë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve për individët në nevojë, familjet e komunitetet me nevoja të veçanta;
- Të promovojë qasje novatore në fushën e shërbimeve të kujdesit social për të siguruar praktika të punës që parandalojnë përjashtimin social të grupeve të veçanta;

PKS ka si referencë Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020, konkretisht dy shtylla:

1. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në cash me shërbime të integruara me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.
2. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së plotë dhe efektive në shoqëri.

PKS reflekton rekomandimet dhe analizat e mëparshme pjesë e dokumenteve të zhvillimit lokal si:

- Plani i Përgjithshëm Vendor i Territorit (2016)- Bashkia Fier;
- Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje, hartuar me mbështetjen e UNDP;
- Plani Vendor për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Fier, 2019-2022;
- Të buxhetojmë për rininë, me rininë, Bashkia Fier, hartuar me mbështetjen e UNFPA, Nëntor 2018.
- Plani Lokal i Zhvillimit, Pjesëmarrjes e Gjithëpërfshirjes për PAK në Rajonin e Fierit.

2.2 Vlerat dhe Parimet e Planit të Kujdesit Social

Vlerat e mëposhtme reflektojnë besimin e komunitetit tek Pushtetit Vendor në rolin e tij lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale në komunitet.

- **Bashkëpunues.** Ne punojmë së bashku me grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile, ofruesit e shërbimeve dhe partnerë të tjerë në komunitet;
- **Shërbime të orientuara drejt nevojave.** Ne dëgjojmë dhe mundohemi t'i përgjigjemi përfitueseve me shërbime me standarde dhe sipas nevojave specifike që ata kanë;
- **Të hapur me publikun.** Ne vendosim në qendër objektivat, masiv performancën tonë dhe raportojmë para publikut suksesin ose mos-suksesin në arritjen e këtyre objektivave;
- **Të besueshëm.** Ne jemi të përgjegjshëm para publikut gjatë ushtrimit të funksioneve, roleve dhe aksioneve si individë dhe si qeverisje;
- **Mbështesim risitë.** Ne jemi krijuar, mësojmë nga eksperiencat dhe rezultatet e arritura, dhe shikojmë përpara për të gjetur rrugë efikase për të zgjidhur problemet dhe për t'i shërbyer publikut.

Parimet e ndjekura për hartimin PKS janë ato të demokracisë përfaqësuese. Ajo çfarë e ka udhëhequr procesin është:

- Gjithëpërfshirja. Përfshirje e të gjithë aktorëve në fushën e shërbimeve të kujdesit social. Nxitja e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve, për të krijuar ndjenjën e përgjegjësisë tek çdo anëtar i komunitetit, për të mundësuar në këtë mënyrë angazhimin e burimeve të reja njerëzore;
- Maksimizimi dhe efikasiteti i përdorimit të burimeve. Në kushtet e burimeve të kufizuara, është bërë dialog me palët dhe negociata me grupet e interesit për vendosjen e prioritetëve;
- Në qendër janë rezultatet. Arritjen e rezultateve që janë kërkuar dhe mbështetur nga shumica e palëve, që kanë marrë pjesë në proces;
- Të drejtat e njeriut, barazia dhe mos diskriminimi. Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.

2.3 Procesi dhe përmbajtja e PKS-së

Plani i Kujdesit Social është ndërtuar në bazë të "modelit logjik të planifikimit", i cili parashikon një numër hapash sipas një kalendari të përcaktuar nga grupi i eksperteve dhe Bashkia.

Faza e parë - Fillimi i procesit:

- Ngritja e grupit të punës;
- Përcaktimi i palëve që janë të interesuar të marrin pjesë në procesin e hartimit të PKS-së;
- Marrja e mbështetjes nga Bashkia Fier;

Faza e dytë - Identifikimi i problemeve dhe çështjeve kritike:

- Mbledhja e të dhënave, analiza dhe procesi i studimit i materialeve (dokumente e raporte) ekzistuese dhe të dhënave e informacioneve, që burojnë prej tyre.
- Konsultimi i dokumenteve kryesore rajonale, që targetojnë zhvillimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Fier:
 - Plani i Përgjithshëm Vendor i Territorit (2016)- Bashkia Fier;
 - Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje, hartuar me mbështetjen e UNDP;
 - Plani Vendor për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Fier, 2019-2022; Të buxhetojmë për rininë, me rininë, Bashkia Fier, hartuar me mbështetjen e UNFPA, 2018;
 - Plani Vendor i Vlerësimit të Nevojave, Analizë e Prioritete për Skemën e Ndhmës së Shërbimeve Shoqërore, Bashkia Fier.
- Konsultimi me faqet e internetit: Bashkia Fier² si dhe “Porta Vendore”³, “Harta e shërbimeve sociale”⁴.
- Konsultime me strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve sociale.
- Realizimi i takimeve me institucione të ndryshme me qëllim marrjen e informacioni dhe konsultimit shkencor e profesional mbi temat përkatëse.
- Konsultime me strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vendor, konsultimet me drejtuesit e projektit dhe koordinatorët, me përfaqësues të Këshillit Bashkiak, me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile që operojnë në Fier, etj.
- Vlerësimi dhe analiza SWOT.

Faza e tretë - Propozime për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social:

- Drejtimet në të cilat do të zhvillohen shërbimet e kujdesit social;
- Synimet që do të adresojnë prioritetet e vendosura;
- Burimet që do të përdoren për të realizuar masat.

Faza e katërt - Hartimi i Plani të Kujdesit Social për Bashkinë Fier:

- Hartimi i planit të veprimit me qëllimet, rezultatet e pritshme, masat/aktivitetet, institucionet bartëse dhe treguesit e matjes së realizimit të aktiviteteve;
- Kostimi i aktiviteteve dhe identifikimi i hendekut të buxhetit (Buxheti i nevojshëm kundrejt buxhetit që sigurohet nga burime të vetat të pushtetit vendor të parashikuara për katër vitet e ardhshme);
- Validimi i dokumentit me Sektorin e Shërbimeve Sociale dhe qytetaret në Bashkinë Fier;
- Aprovimi i PKS-së nga Këshilli Bashkiak;

2 <http://bashkiafier.gov.al/sq-al/Pages/default.aspx>

3 <https://portavendore.al/bashkia-fier/>

4 <http://www.sherbimisocial.gov.al/ep-content/uploads/2016/11/Bashkia-Fier.pdf>

Faza e pestë - Nga planifikimi tek zbatimi i PKS-së:

- Zbatimi i planit;
- Informimi i publikut mbi zbatimin e planit;
- Angazhimi i partnerëve të rinj për zbatimin e PKS-së;
- Prezantimi i instrumenteve për të reflektuar ndryshimet në PKS.

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e këtij dokumenti zbaton një qasje meta-analitike të kombinuar me një proces me pjesëmarrje. Qasja meta-analitike bën të mundur analizën, sintezën dhe nxjerrjen e përfundimeve nga dokumentet ekzistues, siç janë: planet respektive të zhvillimit të bashkisë, planet buxhetore afatmesme, profili social i bashkisë etj. Gjithashtu është marrë në konsideratë, dokumentacioni i vënë në dispozicion nga NPF, me informacion të mbledhur dhe përpunuar gjatë kohës që kjo organizatë ka ofruar shërbime për Bashkinë e Fierit si dhe dokumentacion ndihmës i ofruar nga organizata të tjera, të cilat kanë të njëjtin fokus.

Përveç kësaj, procesi me pjesëmarrjen e punonjësve të Bashkisë bëri të mundur që nëpërmjet grupeve të fokusuara me specialistë të sektorëve përkatës (shërbime sociale dhe buxhetit-financës) të merreshin të dhëna specifike mbi shërbimet që ofron Bashkia e Fierit.

1. Një përshkrim i Bashkisë Fier, bazuar në të dhëna statistikore dhe administrative për situatën demografike (strukturën e popullsisë, fenomenet migratore etj.), situatën ekonomike (sipërmarrjen, punësimin dhe papunësinë), situatën shëndetësorë dhe arsimore;
2. Plani përmban një përshkrim dhe një analizë të burimeve ekzistuese të shërbimeve të kujdesit social (institucionet dhe strukturat publike në nivel vendor, ofruesit jo-publik të shërbimeve sociale dhe burimet njerëzore dhe kapacitetet e tyre profesionale). Gjithashtu Plani përmban edhe burimet financiare të Bashkisë Fier siç është fondi i dedikuar për shërbime sociale në tre vitet e fundit;
3. Një analizë e nevojave për shërbime të grupeve në rrezik bazuar në Planet e Veprimit Lokal të hartuar sipas target grupeve;
4. Një vizion i Bashkisë për ofrimin e shërbimeve sociale;
5. Identifikimi i prioriteteve dhe objektivave të zhvillimit të shërbimeve të kujdesit social;
6. Afatet kohore për progresin e zhvillimit dhe zbatimin të planit. Gjithashtu mënyrën në të cilën aktorët në nivel lokal do të angazhohen në zhvillimin dhe zbatimin e PKS-së, përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrimet e palëve;
7. Një metodologji e monitorimit, vlerësimit dhe ndoshta modifikimit të PKS-së.

3. PREZANTIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË FIER

Fieri shtrihet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, në jug të Fushës së Myzeqesë dhe ndodhet 18 km larg bregut të Detit Adriatik. Bashkia e Fierit shtrihet në një pozitë gjeografike dhe strategjike të favorshme, pasi në këtë Bashki kalojnë dy nga korridoret më të rëndësishme të vendit, Korridori VIII dhe Korridori Blu (Autostrada Adriatik-Joniane). Fieri ndodhet në qendër të rrjetit kombëtar rrugor dhe hekurudhor, duke i dhënë një avantazh zhvillimit ekonomik të zonës, veçanërisht bashkisë.

Bashkia e Fierit karakterizohet nga një terren fushor me lartësi mesatare prej 20 metrash mbi nivelin e detit dhe kufizohet me bashkitë: Divjakë, Lushnje, Roskovec, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë. Bashkia e Fierit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar i mundësuar nga disa avantazhe ndër sektoriale. Ajo përbën 5.7% të tokës bujqësore; kufizohet nga dy lumenj kryesor, Semani në veri dhe Vjosa në jug, të cilët kanë sipërfaqe të mbrojtura natyrore pranë grykëderdhjeve të tyre; zotëron Parkun Arkeologjik Kombëtar të Apolonisë; është e pasur me zona naftë-mbajtëse dhe trashëgon zona industriale si dhe gëzon pozicion strategjik avantazhesh për sa i përket gazifikimit të mundshëm, me vënien në zbatim të Gazsjellësit TAP, që kalon brenda territorit të saj.

Reforma Administrative-Territoriale e ndërmarrë në vitin 2014 ndikoi në Bashkinë e Fierit duke i ndryshuar shtrirjen dhe kufijtë territorialë. Para ndarjes territoriale Bashkia e Fierit, e cila kishte në përbërje të saj vetëm qytetin e Fierit dhe 18 lagjet e tij, kishte një sipërfaqe prej 800 ha dhe një popullsi prej 82,262 banorë⁵. Pas reformës, Bashkia e re e Fierit ka një sipërfaqe prej 620 km² si dhe një popullsi prej 204,548 banorësh. Bashkia Fier përbëhet nga 13 njësi administrative (4 njësi urbane + 9 njësi rurale), të cilat janë: Fier, Mbrostar, Topojë, Dërmenas, Levan, Frakull, Cakran, Libofshë, Portëz dhe Qendër. Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Fieri mbetet qendra e Qarkut të Fierit.

3.1 Të dhëna demografike

Sipas INSTAT, popullsia rezidente e Bashkisë Fier, krahasuar me periudhën para ndarjes së re administrative është më shumë se e dyfishuar. Kështu, sot popullsia e Fierit është vlerësuar të jetë rreth 204,548 banorë të regjistruar. Rreth 46% e popullsisë është e përqendruar kryesisht në qytetin e Fierit, ndërsa pjesa tjetër e saj është e shpërndarë në 9 njësitë administrative. Nga këto njësi veçohet njësia administrative Cakran dhe Levanit të cilat janë dy njësitë më të mëdha në Bashkinë Fier, ku është përqendruar pjesa më e madhe e popullatës së Bashkisë, ndërsa shpërndarja e popullsisë në pjesën tjetër të njësive është afërsisht 5 deri 6%.

⁵ Plani i Përgjithshëm Rregullues i qytetit të Fierit, 2006

Tabela 1. Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011 dhe 2018

NJA/Popullsia	Viti 2011 (INSTAT CENSUS)	Viti 2018
Fier	58,460	92,551
Qendër Fier	4,404	12,749
Libofshë	6,437	10,338
Topojë	4,445	7,579
Mbrostar	7,809	10,833
Dermenas	8,153	12,984
Portëz	8,646	11,753
Levan	8,541	18,060
Frakull	7,139	10,841
Cakran	12,271	16,860
TOTALI	126,305	204,548

Burimi: INSTAT, 2018

Treguesi demografik lidhur me raportin e shpërndarjes së popullsisë urbane/rurale paraqitet me një pamje të ndryshme nga treguesi në nivel kombëtar. Shqipëria pas vitit 2008, ka një raport të popullsisë urban/rural në favor të popullsisë urbane dhe në vitin 2015 rreth 57% e popullatës klasifikohet si popullsi urbane, ndërkohë që në Qarkun Fier ky tregues paraqitet i ndryshëm dhe në favor të popullsisë rurale, me raport 59% me 41%.

Tabela 2. Popullsia rezidente sipas grup-moshave

NJA/ Popullsia	Viti 2011				Viti 2018			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Fier	58,460	10,613	40,170	7,677	92,551	16,802	63,596	12,155
Qendër Fier	4,404	907	2,963	535	12,749	2,624	8,578	1,550
Libofshë	6,437	1,009	4,344	1,083	10,338	1,621	6,978	1,741
Topojë	4,445	699	2,995	751	7,579	1,192	5,107	1,280
Mbrostar	7,809	1,830	5,116	864	10,833	2,538	7,097	1,197
Dermenas	8,153	1,746	5,485	921	12,984	2,781	8,736	1,467
Portëz	8,646	1,875	5,812	959	11,753	2,549	7,901	1,304
Levan	8,541	1,708	5,687	1,145	18,060	3,613	12,026	2,423
Frakull	7,139	1,536	4,823	781	10,841	2,332	7,322	1,185
Cakran	12,271	2,800	8,048	1,423	16,860	3,847	11,058	1,954
TOTALI	126,305	24,723	85,443	16,139	204,548	39,899	138,398	26,255

Burimi: INSTAT, 2018

Popullsia e Bashkisë Fier, nga këndvështrimi gjinor, ruan një diferencë të lehtë për sa i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011 dhe 2018,

tregojnë se raporti gjinor (meshkuj /femra*100) për vitin 2018 është rritur në favor të meshkujve, krahasuar me situatën e raportit gjinor për vitin 2011 (103 meshkuj për çdo 100 femra për vitin 2018).

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe moshë mesatare e saj, (38 vjeç) tregojnë se aktualisht popullata e Bashkisë Fier vazhdon të jetë një popullsi e re, sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi.

Tabela 3. Numri i familjeve sipas njësive administrative të Bashkisë Fier

NJA/ Popullsia	Viti 2018	
	Popullsia	Numri i familjeve
Fier	92,551	31,110
Qendër Fier	12,749	3,614
Libofshë	10,338	2,965
Topojë	7,579	2,342
Mbrostar	10,833	3,042
Dermenas	12,984	3,775
Portëz	11,753	3,106
Levan	18,060	4,932
Frakull	10,841	2,839
Cakran	16,840	4,309
TOTALI	204,548	62,034

Burimi i informacionit: Drejtoria e Gjendjes Civile Bashkia Fier

Për vitin 2018, struktura moshore e popullatës së Bashkisë Fier, tregon se 68% e saj i takon grup-moshës 15-64 vjeç, dhe 20% grup-moshë 0-14 vjeç, të dhëna këto shumë optimiste dhe që tregojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë pune ekonomisht aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo analizohet më poshtë me të dhënat për punësimin.

Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel njësive administrative, tregon se popullata e grup-moshës 15-64 vjeç, është e pranishme me të njëjtat nivele (66-69%) edhe në këto njësi. Gjithsesi, ndërmjet tyre, konstatojmë se komuna Topojë ka nivelin më të ulët të grup-moshës së re (0-14 vjeç) me 16% dhe më të lartin e grup-moshës së vjetër (+65), me 17%. Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore, që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht do të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të njësive administrative.

3.2 Ekonomia

Fieri renditet i treti në Shqipëri për nga rëndësia ekonomike. Bashkia e re ka një ekonomi të fuqishme dhe është qendër e rëndësishme për sa i përket industrive të naftës, bitumit dhe bujqësisë. Fieri ka depozita të mëdha naftë dhe gaz natyror dhe prodhon afërsisht 2,800 fuçi naftë në ditë, si dhe 5 milion m³ gaz natyral në vit. Burime të tjera natyrore përfshijnë rërën bituminoze, materialet inerte, dhe argjilën. Por, si një zonë industriale e rëndësishme e para viteve 90-të, Fieri vuan në veçanti nga papunësia e lartë e shkaktuar nga mbyllja e fabrikave, si dhe nga ndotja mjedisore e lënë pas nga industria tashmë e mbyllur. Pjesa më e madhe e ndotjes vjen nga industria e naftës dhe rafineritë e vajit ushqimor, të cilat janë burimet kryesore të ndotjes mjedisore⁶.

Analiza e zhvillimit ekonomik vendor tregon se 78% e bizneseve të regjistruara në Bashkinë Fier janë biznese të vogla, ndërsa pjesa tjetër rreth 22% janë biznese të mëdha. Pjesa më e madhe e bizneseve është vendosur në njësitë administrative, Fier, Portës, Mbrostar dhe Qendër.

Bizneset e mëdha gjenden të regjistruara si biznese eksport-importi, transportit të udhëtareve dhe mallrave, filiale bankash, njësi shërbimesh, filiale me artikuj ushqimore, etj. Përsa i përket bizneseve të vogla, më së shumti ekzistojnë veprimtari ekonomike në formën e linjave të transportit dhe shërbimeve.

Në përgjithësi njësitë administrative kanë si prioritare ekonominë bujqësore, përveç njësiteve administrative të Topojës, Qendrës dhe Mbrostarit të cilat kanë një drejtim të zhvillimit industrial, kryesisht të naftës dhe materialeve të ndërtimit.

Fieri është një qytet dinamik përsa i përket zhvillimit të ekonomisë vendore. Shifrat tregojnë rritje të numrit të bizneseve të reja që hapen. Kështu gjatë vitit 2018 janë hapur 10% më shumë biznese se në 2017. Nga ana tjetër krahasuar me bizneset që mbyllen, ky raport për vitin 2018 është 4 me 1⁷.

Bujqësia është një prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë në Bashkinë Fier. Në vitet e fundit vihet re një rigjallërim i bujqësisë dhe blegtorisë, të cilat janë edhe sektorët që paraqesin mundësi më të mëdha për punësim dhe zhvillimin ekonomik të bashkisë. Censusi 2011 tregon se të paktën 37% e popullsisë në Bashkinë e Fierit jeton në zona ku mbizotëron ekonomia bujqësore, por shifra mund të jetë edhe më e lartë.

Tabela 4. Numri i bizneseve të reja të regjistruara sipas viteve në Bashkinë Fier

Ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik:	Viti 2017	Viti 2018
Totali	4,262	4,402
Ndërmarrje prodhuese:		
• Bujqësi	210	
• Industri		110
Ndërmarrje shërbimesh:		
• Tregti	3,032	3,372
• Transport	1,020	1,076
• Akomodim dhe shërbim ushqimor		17
• Informacion e komunikim		27

Burimi: Bashkia Fier (Sporteli i shërbimit të QKB-së në Bashki)

⁶ 2016, Dokumenti i raportit përfundimtar të vlerësimit strategjik mjedisor të planit të përgjithshëm të territorit të bashkisë, faqe 65.

⁷ <http://ww.oranews.tv/article/fier-biznesi>

Fusha e Myzeqesë së Fierit dallohet për prodhimtari të lartë bujqësore, ku vend të rëndësishëm zë kultivimi i drithërave (grurë, misër, thekër), pemëtaria, ullishtat, vreshtaria dhe blegtoria. Kohët e fundit është raportuar një rritje e sipërfaqes së mbjellë me perimtari (kryesisht shalqi e pjepër), kultura foragjere, vreshtari e pemëtari, e cila justifikohet me përmirësimin e infrastrukturës rrugore që lidh fshatrat me qytetin e Fierit dhe rritjes së kërkesës së banorëve vendas për këto produkte. Njëkohësisht, në zonat bujqësore të Fierit vihet re edhe zhvillim i blegtorisë (si për shembull në Dërmenas)⁸, favorizuar nga kostoja e ulët e zhvillimit të këtij sektori në krahasim me bujqësinë, kushtet klimatike dhe relievi i përshtatshëm i zonës. Zhvillimi është reflektuar në rritjen e numrit të krerëve dhe krijimin e minifermeve⁹, të krijuara sidomos në vitet e fundit. Përveç blegtorisë, ka marrë zhvillim edhe rritja e shpendëve në pulari (si, p.sh. në Dërmenas) për prodhimin e zogjve dhe të mishit.

3.3 Punësimi dhe papunësia

Bazuar në të dhënat e INSTAT "Punësimi sipas sektorëve ekonomik", gjejmë se gati të gjitha njësitë administrative orientohen drejt ekonomisë agrare, edhe pjesa më e madhe e të punësuarve në këtë bashki janë në sektorin e bujqësisë dhe përpunimin agroushqimor. Ky fakt lidhet me potencialin natyror bujqësor që kanë këto njësi administrative. Madje edhe në njësitë administrative si Dërmenas dhe Topojë që kanë potencial të zhvillimit të turizmit, pjesa më e madhe e të punësuarve janë në sektorin e bujqësisë. Nga ana tjetër qyteti i Fierit është njësi administrative e Bashkisë e cila orientohet drejt ekonomisë aglomeruese, pra tërheq një pjesë të mirë të fuqisë punëtore të bashkisë në tërësi, duke u bërë një qendër e mirëfilltë shërbimesh për bashkinë e re. Ekonomia e dytë në rang bashkie për punësim është industria dhe tregtia.

Duke ju referuar burimeve natyrore, pozicionimit pranë detit por edhe ekzistenca e siteve arkeologjike nga më të rëndësishmit në vend, mund të thuhet se bashkia e Fierit ka një potencial të madh turistik. Megjithatë, shifrat e vizitoreve tregojnë se pavarësisht potencialit, bashkia e Fierit nuk është një destinacion turistik kryesor në vend. Këtë fakt e provon edhe numri i ulët i ndërmarrjeve hotelierisë në Fier, krahasuar me qytete të tjera me profil ekonomik të orientuara drejt turizmit. Kështu krahasuar me Bashkitë Vlorë dhe Durrës, Bashkia e Fierit ka shumë pak ndërmarrje me aktivitet ekonomik hotelieri turizëm.

Tabela 5. Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik

Rrethi	Gjithsej	Bujqësi dhe Peshkim	Industri	Ndërtim	Tregti	Hotele kafe restorante	Transport komunikim	Shërbime te tjera	Shërbime
Durrës	9,937	192	869	544	4,542	1,570	1,034	1,246	3,850
Fier	5,180	59	530	252	2,504	638	553	644	1,835
Vlorë	8,630	284	538	373	2,277	1,084	653	842	2,579

Burimi: INSTAT

Gjatë periudhës së tranzicionit, tregu i punës në qytetin e Fierit, ashtu si në të gjithë vendin, pësoi ndryshime të shumta. U mbyllën, falimentuan, u privatizuan dhe u ristrukturuan pjesa më e madhe e ndërmarrjeve shtetërore, të cilat ishin burimi kryesor i të ardhurave dhe punësimit. Por edhe shpërndarja e tokës që u përkiste fermave shtetërore, për familjet që përfatuan dhe u përfshinë brenda vijës së verdhë, krijoi ekonomi të vogla që në shumicën e rasteve dolën të pamjaftueshme.

⁸ Komuna Dërmenas, Plani i Zhvillimit të Komunës Dërmenas, Fondi Shqiptar i Zhvillimit

⁹ Miniferma janë fermat me mbi 5 krerë lopë

Luhatjet e papunësisë kanë qenë të shpeshta për shkak të reformave ristrukturoese në ndërmarrjet e mëdha të Nxjerrjes dhe Përpunimit të Naftës, TEC-it, Telekomit etj., si burime të rëndësishme punësimi në Fier. Rënien më të madhe, papunësia zyrtare e pësoi në vitin 2017, ku u regjistrua shkalla më e ulët e papunësisë 14.1%. Aktualisht statistikatat e Drejtorisë Rajonale të Punësimit në Fier flasin për 8,200 të papunë të regjistruar si punëkërkues, por mendohet se numri i tyre mund të jetë shumë më i lartë.

Në nivel Bashkie, të gjitha njësitet administrative kanë karakter mbizotërues bujqësor, me përjashtim të Fierit, ku 65,86% e popullsisë aktive është e punësuar në shërbime. Ajo që vihet re edhe nga tabela e mëposhtme është shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë (grup-mosha 15-29 vjeç).

Tabela 6. Shkalla e papunësisë për vitet 2016, 2017 për Bashkinë Fier

Mosha	Gjinia	Shkalla e papunësisë për vendin Viti 2017
15 vjeç e lart	Meshkuj	14.6
	Femra	12.6
	Total	13.7
15-64 vjeç	Meshkuj	15.1
	Femra	12.8
	Total	14.1
15-29 vjeç	Meshkuj	27.0
	Femra	24.0
	Total	25.9
30-64 vjeç	Meshkuj	11.3
	Femra	10.1
	Total	10.8

Burimi: ZV e Punës

Fenomeni i papunësisë është shumë i theksuar edhe tek personat me arsim 8-vjecar, për të cilët është shumë e vështirë hapja e fronteve të reja të punës, pasi ata janë të pakualifikuar për të përmbushur kërkesat që ka sot tregu. Nga ndërmarrjet shtetërore e private rezulton se preferencat janë për fuqi punëtore të kualifikuar e me kriteret specifike.

Në zbatim të programit të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në fushën e punësimit, për vitin 2019 nga Buxheti i Shtetit për Drejtorinë Rajonale të Punësimit në Fier është akorduar një fond prej rreth 10 milionë lekë për zbatimin e Programeve të Nxitjes së Punësimit.

3.4 Arsimi

Popullsia e Bashkisë Fier ka një nivel të përgjithshëm arsimi të ngjashëm në raport me bashki të ngjashme dhe të favorshëm në krahasim me bashkitë fqinje të Qarkut Fier. Tendanca e përgjithshme e analfabetizmit në nivel qarku ka patur një rritje e konsiderueshme në periudhën 2001-2011, nga 0.94% në 3.18%. Kjo tendencë sjell në vëmendje probleme të braktisjes së shkollës për shkak të aksesit të dobët në të, kushteve të jetesës, varfërisë, etj. Në nivel njësish administrative, vërehet që shkalla e analfabetizmit është më e lartë në njësish Levani dhe më e ulët në Fier dhe Topojë.

Sa i takon nivelin arsimor të popullsisë, në Bashkinë Fier, 52.9% e banorëve kanë përfunduar vetëm nivelin bazë arsimor (fillor ose 9-vjeçar). Kjo shifër është më e ulët se mesatarja e Qarkut Fier, por

e përafërt me pjesën më të madhe të bashkive të ngjashme. Siç paraqitet edhe tendenca në nivel kombëtar, kjo shifër e lartë dëshmon për një shoqëri në thelb rurale, pa akses të mirë në shërbimet arsimore.

Tabela 7. Numri i institucioneve arsimore, sipas njësive administrative në Bashkinë Fier

Njësia Administrative	Çerdhe	Kopshte	Cikli fillor	Shkolla 9- vjeçare	Shkolla të mesme të përgjithshme	Shkolla të mesme profesionale
Fier	3	13	0	12	2	2
Cakran	0	8	4	6	1	0
Qendër Fier	0	9	3	3	0	1
Dërmenas	0	8	0	6	2	0
Frakull	0	7	3	5	1	0
Levan	0	9	2	6	1	0
Libofshë	0	5	1	4	1	0
Mbrostar	0	6	0	6	1	0
Portëz	0	6	3	4	0	0
Topojë	0	6	2	3	1	0
TOTAL Publike	2	80	18	55	10	3
TOTAL Private	0	5	0	8	8	1
TOTAL	2	85	18	63	18	4

Burimi informacionit: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Në nivel njësish administrative, përqindja e popullsisë që ka përfunduar vetëm ciklin fillor apo 9-vjeçar luhet në vlera 60-70%, me përjashtim të qytetit të Fierit (36.23%). Kjo tregon për një shpërndarje të pabarabartë në territor të kapitalit njerëzor të kualifikuar, i cili është i përqendruar vetëm në qendrën kryesore të shërbimeve dhe punësimit.

Përqindja e popullsisë vetëm me arsim të mesëm të përfunduar në Bashkinë Fier paraqitet e lartë krahasuar me nivelin kombëtar dhe i qarkut (32.5%, kundrejt 31.4% dhe 30%). Së bashku me bashkitë Patos dhe Lushnjë (pjesë e Qarkut Fier), Fieri ka potencial për të investuar në këtë popullatë, duke nxitur punësimin në sektorë të rëndësishëm për ekonominë e vendit.

Ndjekja e arsimit të lartë në nivel bashkie shënon vlerën 9.7%, e cila është më e ulët se bashkitë e ngjashme dhe se niveli kombëtar (11.8%).

Në tërësi, vitet mesatare të shkollimit për Bashkinë Fier dëshmojnë për norma më të ulëta se niveli kombëtar (9.9 kundrejt 10.2).

Në Bashkinë Fier gjenden 85 kopshte, 18 shkolla fillore, 63 shkolla 9-vjeçare, 18 shkolla të mesme të përgjithshme dhe 4 shkolla profesionale. Në territorin e Bashkisë së re Fier ka zona me diferencë të dallueshme përsa i përket infrastrukturës ekzistuese të objekteve të arsimit.

3.5 Kujdesi Shëndetësor

Fieri ka një larmishmëri institucionesh të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë një spital publik, qendra rajonale të kujdesit shëndetësor, klinika private si dhe shërbimin e urgjencës.

Spitali Rajonal i Fierit ka 421 shtretër të vendosur në 4 godina, si dhe një ekip prej më shumë se 90 mjekësh të specializuar, 240 infermieresh dhe 200 personel administrativ. Poliklinika mbulon shërbimet kryesore dhe është e pajisur me staf të specializuar.

Në qytetin e Fierit ndodhen katër qendra shëndetësore, të ndara gjeografikisht sipas rajoneve. Gjithashtu gjenden edhe klinika, doktorë apo dentiste të tjerë, me praktika që variojnë prej mjekësisë familjare, deri në kujdesin e specializuar.

4. ANALIZA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, NJERËZORE DHE FINANCIARE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL

4.1 Shërbimet Sociale në Bashkinë Fier

Në Bashkinë Fier në nivel rajonal operon Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, e cila ka si funksion bazë kontrollin/inspektimin e zbatimit të legjislacionit dhe akteve normative nga ana e strukturave të pushtetit vendor për menaxhimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë të kufizuar. Shërbimet shoqërore në Bashkinë Fier janë të organizuara si në nivel vendimmarrës ashtu edhe në nivel administrativ. Ndërkohë që në nivel administrativ, shërbimet shoqërore janë akomoduar pranë Drejtorisë së Shërbimit Social.

4.1.1 Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror rrjedhin nga Ligji 121/2016 "Për shërbimet e për kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", neni 33 "Roli i Shërbimit Social Shtetëror".

Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e legjislacionit të shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin, nëpërmjet strukturave të njësisë qendrore dhe drejtorive rajonale. Specifikisht Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social kryen detyrat e mëposhtme:

- a. harton dokumentacionin tip për përfituesit e shërbimeve shoqërore;
- b. kryen vlerësimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- c. mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale;
- d. harton raportin vjetor të vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror dhe kapaciteteve të shërbimeve publike e jopublike;
- e. trajnon personelin e njësisë të qeverisjes vendore që mbulon aspektet e shërbimeve shoqërore;
- f. bashkërendon procesin e hartimit të planeve sociale, duke siguruar që këto plane të përputhen me strategjitë kombëtare;
- g. përditëson dhe mirëmban Regjistrin Elektronik Kombëtar me të dhënat për përfituesit dhe subjektet kërkuese të kujdesit shoqëror;
- h. i dërgon ministrisë statistikat sociale të lidhura me shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pagesat sociale.

4.1.2 Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Fier

Nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier ushtron rolin e vet vendimmarrës dhe administrativ lidhur me NE, PAK dhe shërbimet shoqërore. Drejtoria e Shërbimit Social ushtron funksionet bazuar në të njëjtin ligj (Ligjin 121/2016) neni 36 "Roli i bashkisë" dhe neni 37 "Roli i punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore". Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj duke identifikuar nevojat:

- a. duke vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vullnaribilitetit;
- b. duke hartuar planin social vendor;
- c. duke programuar buxhetet vendore;
- d. duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;
- e. duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;
- f. duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror;

Bazuar në legjislacionin përkatës, shërbimet që ofrohen nga Bashkia Fier për grupet në nevojë janë listuar në Aneksin 2;

Bazuar në të njëjtin ligj, për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë Bashkisë Fier janë ngritur struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror, si: “Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës” dhe “Njësia për barazinë gjinore dhe dhunën në familje”.

4.1.3 Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës

Në Bashkinë Fier është ngritur dhe funksionon Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, e cila ka një specialist dhe është përgjegjëse për:

- Vlerësimin e informacionit për fëmijën në rrezik dhe nivelin e rrezikut;
- Vlerësimin e nevojave të fëmijës dhe familjes;
- Monitorimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve viktime të dhunës, abuzimit dhe keqtrajtimit;
- Koordinon funksionimin e GTM¹⁰;
- Bashkëpunon me çdo strukturë përgjegjëse për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;
- Organizon takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës;
- Evidenton nevojat përmes vlerësimit të gjendjes reale social-ekonomike;
- Shërben si qendër informacioni;
- Punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në njësitë administrative të bashkive, janë pjesë e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NjVNR) dhe kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve.

4.1.4 Njësia për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje

Njësia për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, funksionon në bazë të Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, neni 7 “detyrat dhe përgjegjësitë e autoritetit përgjegjës”. Në bazë të këtij ligji njësia për barazinë gjinore ka këto detyra:

- Lehtëson dhe mbështet bashkëpunimin e organeve të qeverisjes vendore me institucionet lokale për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje;

¹⁰ Grupi Teknik Multidisiplinar

- Siguron ekspertizë teknike për bashkinë për çështje të barazisë gjinore dhe marrjen e masave për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje;
- Mbështet organet e qeverisjes vendore dhe lehtëson bashkëpunimin e ngushtë të tyre me organizatat jofitimprurëse lokale dhe organizma akademike, për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme si dhe për programe në mbrojtje të viktimave të dhunës në territorin që ato mbulojnë;
- Bashkëpunon me strukturat përkatëse në ministrinë përgjegjëse, për çështjet e barazisë gjinore dhe mbështet organet e qeverisjes vendore për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e statistikave vendore të ndara sipas gjinisë duke respektuar formatin e miratuar nga autoriteti përgjegjës;
- Inicion dhe merr pjesë aktive në aktivitetet dhe fushatat ndërgjegjësuere për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje, të organizuar nga bashkia ose që organizohen në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për barazinë gjinore dhe shoqërinë civile (takime, workshope, diskutime në media);
- Përgatit informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për pasqyrimin e çështjeve gjinore në website, buletinet apo mjetet e tjera të informimit të bashkisë.

Në bashkëpunim me UNDP është hartuar edhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje, i cili ka hedhur edhe shinat e punës për funksionimin e kësaj drejtorie.

4.1.5 Shërbimet ekzistuese të për kujdesit shoqëror

Nëse i referohemi hartës së shërbimeve sociale¹¹ dhe shpërndarjes së tyre në territorin e bashkisë Fier, vërejmë se pjesa më e madhe e shërbimeve janë të përqendruara në zonën urbane të bashkisë, ndërsa mbulimi gjeografik i zonës rurale me shërbime është pothuajse zero. Përsa i përket tipologjisë së shërbimeve, në Fier gjejmë shërbime sociale rezidenciale dhe ditore. Shërbimet rezidenciale, janë shërbimet e ofruara nga Qendra rezidenciale për të moshuarit, e cila mbulon nga pikëpamja territoriale të gjithë rajonin dhe më gjerë. Ndërsa shërbimet ditore, janë shërbime të ofruara për fëmijët, të moshuarit dhe PAK.

Fieri ka një numër krahasimisht të lartë institucionesh sociale (19), i cili rezulton më i lartë se Elbasani dhe Vlora, por më i ulët se Durrësi e Shkodra. Në nivel qarku janë në funksionim 2 qendra për të moshuar (1 publike rezidenciale e 1 private ditore), 9 qendra sociale për fëmijë (jo publike), 3 shërbime sociale private ditore, për familjet dhe komunitetet, 3 shërbime sociale ditore për personat me aftësi të kufizuar, dhe një qendër sociale për të rinjtë.

Tabela 7. Shërbimet Sociale në Bashkinë Fier

SHERBIMET SIPAS TIPOLOGJISË:	Publike	Jo-publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	0
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	1
Shërbime sociale për fëmijët	0	9
Shërbime sociale për familjet dhe komunitetet	2	0
Shërbime sociale për PAK	1	2
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	3
TOTAL	5	14

Burimi informacionit: Bashkia Fier

11 <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2016/11/Bashkia-Fier.pdf>

Një kontribut të madh në plotësimin e nevojave sociale të popullatës kanë dhënë ato pak organizata jo-qeveritare, që veprojnë në territorin e Bashkisë së Fierit.

Së fundmi në Fier është ngritur **“Njësia për vlerësimin e nevojave dhe referimit (NJVNR)”** e përbërë nga përfaqësues të sektorit të pagesave në para (ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar etj.) dhe sektori i përkujdesit social (shërbimet sociale në komunitet, rastet e dhunës në familje, rastet e abuzimit dhe problematikave të fëmijëve). Me ngritjen e kësaj njësie, bashkia nga njëra anë ka realizuar një prej detyrimeve ligjore¹², dhe nga ana tjetër ka siguruar që strukturat e saj të jenë më afër problemeve të komunitetit, për rrjedhojë edhe situata sociale e tij është më mirë e dokumentuar.

Megjithëse NJVNR është ngritur dhe funksionon, mbetet shumë për të bërë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të stafit të kësaj strukture. Detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas ligjit diktojnë nevojën për një staf të specializuar, si në fushën e shërbimeve të kujdesit social, ashtu edhe në identifikimin (outreach) e rasteve, mbajtjen e rekordeve, prodhimin e të dhënave (statistikave vendore) dhe vlerësimin e nevojave për shërbime sociale të komunitetit në territorin e bashkisë. Gjithashtu kjo zyrë ka nevojë për rregullore të brendshme, procedura, procese, dhe standarde me qëllim që të përcaktohet qartë mënyra se si do të funksionojë kjo zyrë, si pjesë e organogramës së bashkisë, por edhe si pjesë e rrjetit të institucioneve të tjera me varësi vendore ose qendrore, që ofrojnë shërbime.

NJVNR kërkon staf ashtu siç e parashikon ligji, por aktualisht çdo njësi administrative ka vetëm një punonjës. Kështu problemet identifikohen në njësitë administrative dhe për mungesë burimesh njerëzore, analizohen në qendër. Për këtë arsye është e nevojshme rritja e numrit të stafit proporcionalisht me numrin e popullsisë në çdo njësi administrative, ashtu siç e parashikon ligji.

4.2 Burimet njerëzore

Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social në Bashkinë e Fierit ka bërë dhe bën përpjekje e maksimale për të përmbushur nevojat e popullatës për shërbime sociale, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet lokale dhe qendrore, por akoma ekziston hendeku i nevojave dhe mundësisë për t'i plotësuar ato. Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Fier ka 5 drejtime dhe 33 punonjës, me detyra dhe përgjegjësi të ndara sipas grupeve në rrezik që mbulon secili sektor.

Tabela 8. Drejtoria Shërbimit Social Fier

Emërtesa e pozicionit:	Nr. i punonjësve
Drejtor i Shërbimit Social	1
Specialist i Ndhmës Ekonomike	14
Specialist i pa-aftësisë dhe invalidëve të punës	1
Specialist i barazisë gjinore dhe dhunës në familje	1
Specialist i NJMF dhe marrëdhënieve me OJF	1
Specialistët e qendrës PAK: 7 mësues (nga DAR) , 2 logopedist, 2 psikolog, 4 punonjës social, 2 kuzhinier, 2 shoferë, 1 sekretare	13(+7)
Sanitare 2	2
TOTAL	33 (+7)

Burimi informacionit: Bashkia Fier

¹² Ligji 121/2016 “Për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” Neni 36 pika 3.

Nisur nga vlerësimet që janë bërë për stafin e Bashkisë Fier, rezulton të jetë staf i kualifikuar dhe i dedikuar për shërbimet që ofron. Megjithatë nevoja për të përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet e tyre mbetet e përhershme për faktin e ndryshimeve social ekonomike që ndodhin në kohë dhe si rrjedhojë e zgjerimit të territorit si rrjedhojë e reformës territoriale.

Përmirësimi i mekanizmave dhe kapaciteteve profesionale nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin është një mundësi e mirë për bashkinë që të ofrojë shërbime sa më të përshtatshme dhe me standarde. Plotësimi i nevojave të popullatës është prioriteti i punës së Drejtorisë së Shërbimit Social, duke qenë se edhe nevojat ndryshojnë nga njëri vit në tjetrin. Stafi shprehet i gatshëm që t'i mbulojë këto nevoja me një shërbim të kualifikuar.

Një sfidë tjetër që paraqitet është menaxhimi apo monitorimi i Bashkisë për organizatat që ofrojnë shërbime të kujdesit social. Bashkia ka në fokus të saj plotësimin e nevojave sociale dhe normalisht mirëpret organizatat jo-qeveritare të japin kontributin e tyre duke garantuar punën e tyre në terren. Bashkia nga ana tjetër merr përgjegjësinë që këto organizata, që ofrojnë shërbime, të kenë staf të kualifikuar për plotësimin e nevojave të popullatës dhe garanton standardet profesionale të shërbimeve.

4.3 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale në Bashkinë e Fierit

Për vitin 2019 Bashkia ka vënë në dispozicion 5.000.000 lekë për projekte për shërbime sociale për fëmijët, komunitetet, gratë, moshën e tretë etj.

Buxhetet që hyjnë në zëra të tjerë, por me impakt tërësisht social, siç është ndërtimi i rampave, ristrukturimi i shtëpisë së të moshuarve etj., bëhen shpesh herë të vështira për t'u përlloritur, pasi këto shpenzime hyjnë si pjesë e zërave të tjerë në buxhetin e Bashkisë, pavarësisht së ato kontribuojnë në rritjen e shërbimeve të përkujdesit social.

Me gjithë përmirësimet në planifikimin e buxhetit, shpesh herë ndodh që Shërbimet Sociale të mos jenë prioritet i politikave të qeverisë vendore dhe kjo shprehet nga buxheti i kufizuar që iu vihet në dispozicion këtyre shërbimeve. Për Bashkinë e Fierit mund të themi se ka një rritje modeste të buxhetit për shërbimet sociale, e cila nuk është relevante me nevojat në rritje të komunitetit për shërbime. Megjithëse ndryshimet në Ligjin e Buxhetit i kanë deleguar bashkive kompetenca të reja dhe fleksibilitet sa i përket planifikimit dhe menaxhimit të fondeve sipas nevojave, buxheti në dispozicion të shërbimeve sociale nuk ka qenë asnjëherë i krahasueshëm me nevojat.

Burimet financiare për shërbimet sociale ofrohen në pjesën më të madhe nga qeveria qendrore që janë në formën e grantit të kushtëzuar. Qeveria qendrore është ofruesi më i fuqishëm i shërbimeve sociale nëpërmjet programeve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, arsimimit dhe kujdesit shëndetësor. Është përgjegjësia e saj të menaxhojë, koordinojë, financojë e mbikëqyrë zbatimin e politikave sociale.

Tabela 9. Buxheti i Bashkisë Fier sipas programeve buxhetore

PROGRAMET BUXHETORE:	Buxheti në /000 lekë për 2018	Buxheti në /000 lekë për 2019
Planifikim Menaxhim Administrim	465,348	764,574
Mbrojtja nga zjarri	33,084	33,084
Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	56,238	63,400
Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave		3,681
Rrjeti rrugor		8,494
Zhvillimi i komunitetit(mbetjet e ngurta)	139,374	154,903
Zhvillimi i komunitetit (shërbimet publike vendore)	294,345	462,876
Zhvillimi i komunitetit (shërbimet rurale)		27,695
Shërbimet kulturore	64,825	70,754
Arsimi baze dhe parashkollor		187,157
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	350,649	31,952
Arsimi mbështetës (konviktet)		142,172
Programi i rinisë Sporteve dhe Komuniteteve	26,000	
Strehimi dhe Shërbimet Sociale	3,000	
Investime	393,925	
TOTALI	1,826,788	1,950,742

Burimi informacionit: Porta Vendore-Bashkia Fier

Qeveria vendore është aktor kyç, në sigurimin e shërbimeve sociale dhe kompetencat e saj janë duke u rritur hap pas hapi nëpërmjet decentralizimit, por buxhetet për këto shërbime ngelen akoma shumë të limituara.

Nga të dhënat e buxhetit për vitet 2018 dhe 2019, në tabelën nr. 8 shihet qartë se:

- për vitin 2018 buxheti i planifikuar për “strehim dhe shërbime sociale” është 0.16% e buxhetit total të bashkisë;
- është planifikuar një buxhet modest për komunitete në të njëjtin zë me programin e “sporteve dhe të rinisë”;
- për vitin 2019, programet për “strehim, shërbime sociale dhe komunitete”, janë planifikuar nën programin e “Zhvillimi i komunitetit (shërbime publike vendore)” dhe përbejnë rreth 8.5% të buxhetit të bashkisë.

4.4 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesit social në Bashkinë e Fierit

Organizata “Terre des Hommes”, ofron shërbime komunitare, mbështetje psiko-sociale, ligjore dhe ekonomike për fëmijët dhe familjet e tyre, duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse. Kjo organizatë operon që prej vitit 2006, vit në të cilin ka ngritur NJMF në Bashkinë Fier, pas Bashkisë Elbasan. Gjithashtu organizata ofron shërbime për integrimin e fëmijëve dhe familjeve në nevojë të kthyer nga emigracioni ose në rrezik migrimi.

Në të ardhmen parashikohet që të hapet një qendër për fëmijë tek banesat sociale, e cila do të ketë në fokus fëmijë të fshatit Drizë, por jo vetëm. Në këtë qendër do ofrohen shërbime për të gjithë fëmijët në situata të vështira sociale dhe ekonomike.

Organizata “Save the Children”, ofron mbështetje për fëmijët e dy kopshteve Rom dhe familjeve të tyre duke forcuar kapacitetin e tyre prindëror;

Fondacioni “Ndhmë për Fëmijët” po zbaton projektin “Shërbime Sociale të Integruara për Zhvillim të Qëndrueshëm Shoqëror dhe Ekonomik të Romëve dhe Egjiptianeve” në kuadër të programit “Askush të Mos Mbetet Pas”, i zbatuar nga UN në Shqipëri, financuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri dhe nën mbikëqyrjen e UNDP Shqipëri.

Ndërhyrja e programit fokusohet në ofrimin e shërbimeve sociale në nivel lokal, ku ofrimi i shërbimeve është realizuar në masë të madhe. Ai synon njerëzit lokalë dhe ka një fokus të veçantë tek njerëzit me aftësi të kufizuara dhe komunitetet Rome dhe Egjiptiane, që kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes social, duke u mundësuar atyre që të kërkojnë dhe të kenë qasje më të mirë në sistem si dhe të kontribuojnë në përpjekjet për përfshirjen sociale. Paralelisht, programi mbështet bashkitë dhe ofruesit e shërbimeve vendore për të ofruar shërbime më efektive dhe efikase dhe për të promovuar përfshirjen sociale. Përveç nivelit lokal, programi është duke ancoruar ndërhyrjet e tij në nivel administrativ. Kjo ka të bëjë me zhvillimin e mëtejshëm dhe monitorimin pasues të zbatimit dhe financimit të politikave relevante për përfshirjen sociale. Temat e barazisë gjinore dhe qeverisjes së mirë priten në të gjithë sektorët dhe nivelet e tjera të zbatimit të programit.

“Voice of Roma”, ofron mbështetje për familjet rome nëpërmjet projekteve të ndryshme, kryesisht në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve rome;

“Qendra Sociale Murialdo”, ofron shërbime për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nëpërmjet aktiviteteve psiko-sociale, mbështetjes shkollore dhe aftësimin profesional;

Gjithashtu në kuadrin e shoqërisë civile funksionojnë edhe shoqatat të cilat kryejnë aktivitete bamirësie ose lobimi për grupet e tyre të interesit, siç janë fëmijët pa kujdes prindëror, personat me aftësi të kufizuara, invalidët etj. Por nglet fakt që në Bashkinë Fier numri i shoqatave lokale është shumë i limituar.

5. ANALIZA E NEVOJAVE SOCIALE TË GRUPEVE NË RREZIK

Në një analizë të përmbledhur grupet e identifikuara në nevojë në Bashkinë Fier janë si më poshtë:

Fëmijët 0-18 vjec:	<ul style="list-style-type: none"> • jetimë, me aftësi të kufizuara fizike, mendore, sensore. • që lypin, punojnë të braktisur, të dhunuar, të trafikuar, të pashoqëruar në emigracion.
Gratë:	<ul style="list-style-type: none"> • me aftësi të kufizuara fizike, mendore, sensore, gra k/familjare. • të dhunuara (viktima të dhunës në familje, gra të divorcuara • të trafikuar (viktima të trafikimit dhe prostitucionit).
Të rinjtë:	<ul style="list-style-type: none"> • me aftësi të kufizuara fizike, mendore, sensore, të droguar. • të papunë. • të përfshirë në vepra kriminale.
Te rriturit:	<ul style="list-style-type: none"> • me aftësi të kufizuara fizike, mendore, sensore (të verbër, autik). • të papunë, • të alkoolizuar, të droguar, të dhunshëm.
Te moshuarit:	<ul style="list-style-type: none"> • të vetmuar / të braktisur. • me aftësi të kufizuara fizike, mendore, sensore. • me të ardhura te pamjaftueshme.

5.1 Familjet e varfëra

Sa i takon nivelit të varfërisë, nga Studimi për Matjen e Standardit të Jetesës, LSMS (INSTAT, 2012) rezulton se në raport me qarqet e ngjashme, situata e Fierit paraqitet relativisht e mirë përse i përket varfërisë ekstreme.

Sipas studimeve të realizuara për matjen e shkallës së varfërisë, Bashkia e Fierit përfaqëson një zonë me popullsi dhe mirëqenien mesatare, burime punësimi dhe të ardhurash të konsiderueshme. Krahasuar me qytete të tjera të vendit, treguesit e varfërisë janë më të ulët. Qyteti i Fierit, si dhe bashki të tjera që gjenden në zonën fushore-bregdetare (Tiranë, Durrës, Vlorë, etj.), karakterizohet nga një ekonomi e diversifikuar, me dy ose më shumë burime punësimi dhe të ardhurash më të shumta në raport me zona të tjera. Bazuar në treguesit e shpërndarjes së varfërisë (Harta e Varfërisë), Bashkia Fier përfshihet në grupin e parë (shkalla e varfërisë) me 0,1-10% të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike¹³.

Për vitin 2018, në Bashkinë Fier janë trajtuar me Ndihmë Ekonomike mesatarisht 658 familje në muaj, prej të cilave 48 familje rome dhe 111 familje me kryefamiljare grua. Fondi vjetor i Ndihmës Ekonomike shkon në shifrën 28,214,000 lekë.

¹³Plani vendor i vleresimit të nevojave. Bashkia Fier 2013

Tabela 10. Të dhëna për ndihmën ekonomike ndër vitet 2016-2018

Njësitë administrative Fier	Numri mesatar i familjeve përfituese të NE			Nga këto familje me kryefamiljare nëna	
	2016	2017	2018	2017	2018
Fier	474	409	191	136	17
Qendër Fier	55	48	44	11	5
Libofshë	15	11	109	5	10
Topojë	1	2	35	1	2
Mbrostar	6	8	33	2	9
Dermenas	51	56	54	17	9
Portëz	34	36	44	16	13
Levan	9	9	93	4	14
Frakull	0	0	32	0	5
Cakran	16	15	23	4	6
Familje gjithsej	660	594	658		
Fondi NE gjithsej (në mijë lekë)	37,226	31,304	28,214		

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

Referuar ndryshimeve të fundit ligjore, familjet e varfëra, banore në territorin e Bashkisë, kanë të drejtë të aplikojnë për ndihmë ekonomike. Vlerësimi i tyre si përfitues ose jo, bëhet nga një sistem vlerësimi me pikë i gjendjes së tyre social ekonomike, i të ardhurave nga punësimi, nga sistemi i pensioneve, nga aktiviteti ekonomik privat apo nga pasuria, të vërtetuara këto nga institucionet përkatëse. *Sistemi Elektronik i Aplikimit dhe Vlerësimit* bazohet në disa variabla të përcaktuar si indikatorë të nivelit të varfërisë.

Tabela 11. Shpërndarja e transfertave në para sipas kategorive nga transfertat e kushtëzuar

INDIKATORËT/VITET:	Viti 2018	Fondi aprovuar në dhjetor 2018 (mujor)
Nr. i familjeve që aplikojnë për ndihmë ekonomike	1,511	
Numri mesatar mujor i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike	658	2.800.000
Individë me statusin jetim që përfitojnë ndihmë ekonomike	32	96.000
Individë viktimë të trafikimit që përfitojnë ndihmë ekonomike	2	6.000
Individë viktimë të dhunës në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike	26	78.000
Fëmijë në kujdestari të një familje kujdestare	26	234.000
Individë më pagesë pa aftësi	3,841	48.573.796
Invalid Pune	2,979	9.410.000

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

5.2 Fëmijët në rrezik

5.2.1 Fëmijët e familjeve të varfëra

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët, UNICEF, në një raport lidhur me fëmijët e familjeve të varfëra, ka publikuar se 10% e familjeve me fëmijë deri në 18 vjeç, jetojnë me vetëm 30 - 50 dollarë në muaj dhe se ndihma ekonomike u mbulon këtyre familjeve të varfëra vetëm 20 për qind të nevojave jetësore.

Fëmijët e familjeve të varfëra në përgjithësi janë subjekt i braktisjes së shkollës dhe punësimit të hershëm informal. Për këtë arsye nevojitet gjithmonë një koordinim i vazhdueshëm me të gjitha organet kompetente për parandalimin e këtyre fenomeneve.

Tabela 12. Të dhëna për fëmijët e familjeve të varfëra

Numri i familjeve përfituese të NE me fëmijë nën 15 vjeç:	2018				
	Totali	1 fëmijë	2 fëmijë	3 fëmijë	4 fëmijë
Fier	87	23	17	29	18
Qendër Fier	86	11	21	20	34
Libofshë	58	14	19	16	9
Topojë	54	11	22	15	6
Mbrostar	45	8	16	10	11
Dermenas	35	12	17	4	2
Portëz	52	9	23	5	15
Levan	126	16	17	51	42
Frakull	68	11	29	11	17
Cakran	47	7	14	13	13
Familje gjithsej (nr.)	658	122	195	174	167
Fëmijë gjithsej	1702	122	390	522	668

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

Nga Tabela nr.12 duket qartë një numër relativisht i lartë i familjeve me fëmijë nën 15 vjeç, që përfitojnë ndihmë ekonomike në Levan. Gjithashtu vërehet një korelacion midis familjeve që marrin ndihmë ekonomike dhe pasjes së fëmijëve nën 15 vjeç. Duke krahasuar të dhënat e Tabelës nr. 11 me Tabelën nr. 10 rezulton që familjet përfituese të ndihmës ekonomike kanë në masë të madhe fëmijë nën 15 vjeç.

5.2.2 Fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë

Referuar analizës së bërë në kuadrin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015-2017", gjatë periudhës Korrik 2015 - Qershor 2016, janë menaxhuar 14 raste të fëmijëve të identifikuar në situatë rruge.

Tabela 13. Numri i rasteve të fëmijëve në ndjekje sipas problematikave

PROBLEMATIKA:	Numri i rasteve 2018
Dhunë në familje	60
Varfëria	35
Fëmijë që punojnë	20
Total	115

Burimi: NJMF Fier

Drejtoria Rajonale e ISHPSHS Fier, gjatë inspektimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin në Fier, ka kërkuar zbatimin me rigorozitet të kuadrit legjislativ për ndalimin e shfrytëzimit të fëmijëve. Në vitin 2016 janë konstatuar të punësuar të mitur në moshën 16-18vjeç, 19 të mitur në subjektet me aktivitet fasoneri dhe bar kafe.

Në Bashki numri i fëmijëve brenda këtij grupimi është relativisht i lartë. Kjo vjen për disa arsye, si: divorcet e prindërve, lëvizjet demografike, braktisja e shkollës, kushtet social-ekonomike, etj.

Tabela 14. Numri i rasteve të fëmijëve në situatë rruge të menaxhuara për vitin 2018

Bashkia Fier		Deri në vitin 2018 e në vazhdim	Nr. i rasteve të reja
	Numri i rasteve të menaxhuara në total	115	18
Sipas grup-moshës	0-6 vjeç	68	7
	7-14 vjeç	39	9
	15-18 vjeç	8	2
Sipas gjinisë	Femra	78	9
	Meshkuj	37	9
	Numri i rasteve të fëmijëve të identifikuar/referuar nga:		
Sipas institucionit referues	NJMF		27
	Policia		20
	OJF		5
	Prind		10
	Fëmijë		13
	Institucion arsimor		25
	Institucion shëndetësor		0
	Administrator social		12
	Media		3

Burimi: Bashkia Fier NJMF

Për të ardhmen sfidat në menaxhimin sa më të mirë të nevojave që kanë fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë, janë të lidhura me:

- Zhvillimin e programeve për edukimin e arsimimin e tyre;
- Zhvillimin e programeve mbështetëse për familjet e tyre;
- Zbatimin e legjislationit dhe forcimin e kapaciteteve të ISHPSHS, Bashkisë, organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë punësimin e fëmijëve;
- Bashkëpunimin e koordinimin ndërmjet institucioneve e partnerëve për reduktimin e punës së fëmijëve;
- Kthimin në shkollë për ata që kanë braktisur dhe ofrimi i alternativave të formimit profesional për ata në moshë pune;
- Krijimin e mundësive për ndihmë apo punësim edhe për familjarët e tyre.

5.3 Personat me aftësi të kufizuar

Sipas Njesisë së Shërbimit ndaj personave me aftësi të kufizuara, numri i PAK në Bashkinë e Fierit është 3,125. Tabela nr.14 jep informacion mbi numrin e PAK sipas kategorisë së aftësisë së kufizuar. Numri i personave kujdestarë që përfitojnë pagesë nga skema e PAK është 491, ose 15,7 % e PAK përfitojnë edhe shërbimin e kujdestarisë.

Tabela 15. Ndarja sipas kategorive e numrit të personave me aftësi të kufizuar

Kategoria PAK:	Numri PAK	% PAK sipas kategorisë
Invalidë me pension pleqërie	186	5.95%
Invalidë pune të pjesshëm	312	9.98%
Invalidë pune të plotë	1124	35.97%
Para dhe teraplegjikë	331	10.59%
Kujdestar për para-tetraplegjikë	331	10.59%
Të verbër	681	21.79%
Kujdestar për të verbër	160	5.12%
TOTALI	3,125	100.00%

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

Ndikimi i kushteve social ekonomike për këto grupe është i madh. Veç të tjerash nuk ka shkollë të specializuara. Pavarësisht vështirësive Bashkia Fier ka ngritur qendrën multifunksionale për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe ka plane për ti zhvilluar më tej këto shërbime.

Duke ju referuar të dhënave të “Planit Lokal të Zhvillimit, Pjesëmarrjes e Gjithëpërfshirjes për PAK” në Rajonin e Fierit, numri i personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Fier është 3.4% e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Nga këta 6.6% janë invalidë në pension pleqërie, 11% janë invalidë të pjesshëm pune, 37% janë invalidë pune të plotë, 5.6% janë para dhe tetraplegjikë, 9.7% janë të verbër dhe 30% janë me aftësi të kufizuar.

Brenda numrit të mësipërm, 62.4% e personave me aftësi të kufizuar në qytetin e Fierit janë në moshë pune. Prej tyre, 72%, ose 1,260, janë invalidë pune dhe 28%, ose 484, janë persona me aftësi të kufizuar fizike dhe mendore¹⁴.

¹⁴ Planit Lokal i Zhvillimit, Pjesëmarrjes e Gjithëpërfshirjes për PAK në Rajonin e Fierit

Tabela 16. Të dhëna për Personat me Aftësi të Kufizuar sipas njësive administrative

Njësia	Individë me aftësi të kufizuar deri ne Dhjetor 2018			
	Meshkuj	Femra	Totali	Fëmijë deri ne 15 vjeç
Fier	743	507	1250	105
Qendër Fier	84	72	156	12
Libofshë	78	67	145	16
Topojë	82	53	135	9
Mbrostar	128	75	203	26
Dermenas	120	97	217	27
Portëz	100	69	169	17
Levan	181	116	297	26
Frakull	99	69	168	35
Cakran	218	167	385	43
TOTAL	1,833	1,292	3,125	316

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

Numri i kursantëve në Qendrën Rajonale të Formimit Profesional është 5 persona me aftësi të kufizuar, nga të cilët 1 është femër. Nga totali prej 8,334 persona të regjistruar si punëkërkues të papunë për rajonin e Fierit¹⁵, vetëm 24 janë persona me aftësi të kufizuar.

Identifikimi i nevojave që paraqesin personat me aftësi të kufizuar në këtë rajon has në shumë vështirësi, pasi, Administratorët Socialë në kushtet e ngarkesës në punë nuk realizojnë dot një vlerësim të tillë. Gjithashtu ndjehet mungesa e të dhënave dhe digjitalizimi i tyre, e cila vështirëson punën për vlerësimin e nevojave.

Disa grupe, siç janë gratë me aftësi të kufizuara, apo romët me aftësi të kufizuar, vuajnë diskriminim e shumëfish të për shkak të përkatësisë gjinore apo racore.¹⁶

Referuar analizës së situatës, sfidat për këtë grup social do të adresohen nëpërmjet:

- Ngritjes së Qendrave të rehabilitimit;
- Ngritja e shërbimeve diagnostikuese në fëmijërinë e hershme;
- Ngritjes së shkollave/klasave të specializuara me programe zhvillimi sipas vështirësisë dhe grup-moshave;
- Punësimin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi;
- Përshtatjen e mjediseve të ndërtesave publike, sigurimin e aksesit në shërbime dhe ofrimin e informacionit në gjuhën Brail;
- Zgjerimin e shërbimeve rehabilituese;
- Shtimit të shërbimeve alternative në mjedis familjar;
- Sensibilizim i komunitetit dhe mbështetje psiko-sociale për familjen;
- Mbështetje për të verbërit që të përfitojnë të drejtat sipas ligjit.

¹⁵ Po aty

¹⁶ Po aty

5.4 Familje të pastreha

Kërkesat e qytetarëve për strehim në Bashkinë e Fierit janë në rritje dhe po kështu janë nevojat për investime në këtë sektor. Deri në vitin 2016, 297 familje kanë përfituar banesë sociale në Fier¹⁷, ndërkohë numri i kërkesave pranë zyrës së strehimit është shumë më i madh. Kështu numri i familjeve të regjistruara si të pastreha në qytetin e Fierit është mbi 1,500 familje.

Tabela 17. Numri i familjeve të pastreha të regjistruara sipas viteve dhe kategorive

Kategoria	Numri familjeve te pastreha të regjistruara		
	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
PAK	44	3	4
Gra Kryefamiljare (të divorcuara)	14	4	21
Përfituesit e ndihmës ekonomike	0	2	0
Çiftet e reja	11	2	25
Familjet me një prind	25	1	
Emigrantët e rikthyer	0	1	0
Punëtorët emigrantë	0	0	0
Viktima të dhunës në familje	1	0	1
Familje Rome	0	0	0
Familje Egjiptiane	3	0	0
Familje te tjera---	77	20	34

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

Familjet e pastreha përfituese janë miratuar sipas procedurës ligjore nga Këshilli i Bashkisë, ndërsa kontratat me secilën prej familjeve përfituese janë lidhur nga Drejtoria Rajonale e Entit të Banesave Fier, sipas llojit të apartamentit të përfituar (sipërfaqe banimi /për frymë) me vlerat përkatëse. Nevoja për strehim social vazhdon të mbetet mjaft e madhe në Bashkinë e Fierit. Raporti i numrit të përfituesve kundrejt numrit të aplikantëve për këtë bashki është 1 me 5.

Tabela 18. Numri i familjeve përfituese nga programet e strehimit sipas kategorive

Kategoria	Banesa sociale, kredi e butë, bonus qiraje	
	2017	2018
PAK	22	1
Gra Kryefamiljare	14	0
Çiftet e reja	7	1
Familjet me një prind	8	2
Punëtorët emigrantë	2	0
Familje Egjiptiane	1	0
Gra të dhunuara	0	0
Familje në banesa jashtë kushteve të strehimit, rrezik shembje dhe që skanë përfituar nga Ligji nr.7652	19	5

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

17 Ministria e Zhvillimit Urban-Strehimi Social në Shqipëri, Vlerësim i Situatës, Qershor, 2016

Kategoritë përfituesve të strehimit social në numër më të madh janë familjet, banesat e të cilëve janë jashtë kushteve të strehimit; personat me aftësi të kufizuar dhe gratë kryefamiljare. Kategoritë vulnerabël me numrin më të vogël të përfituesve për strehim social janë: gra të dhunuara (asnjë) ose viktima të dhunës në familje. Pjesa më e madhe e aplikimeve është përqendruar tek programi “Banesa me kosto të ulët”. Buxheti për strehimin social në Bashkinë Fier, për vitin 2018 ka qenë 2.5 % e buxhetit total të bashkisë.

5.5 Dhuna në familje

Sipas të dhënave të Bashkisë Fier, për vitin 2018, janë 103 raste të denoncuara të dhunës në familje pranë Njesisë së BGJDHF.

Gjatë periudhës 2012-2013, PNUD-i u ka ofruar asistencë teknike disa bashkive në bazë të Letër-Marrëveshjeve për krijimin e RKK dhe ndërtimin e kapaciteteve për përfshirjen e perspektivës gjinore në planet e zhvillimit vendor. Falë kësaj mbështetjeje, specialistët e BGj dhe DhF janë aktivë në drejtimin dhe bashkërendimin e punës me institucione dhe organizata të tjera që veprojnë në territorin e bashkisë për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje.

Në vitin 2014 me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 23, datë 10.03.2014, u aprovua “Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje 2014-2015”, i cili konsiderohet akoma aktual përsa i përket objektivave që Bashkia i ka në këtë drejtim.

Duke ju referuar këtij Plani, Drejtoria e Shërbimit Social pranë Bashkisë Fier ka patur dhe ka prioritet ndihmën e familjeve në nevojë dhe kryesisht familjeve me gra krye-familjare. Duke ju referuar këtij dokumenti, pavarësisht përpjekjeve që janë bërë dhe po bëhen, ka mungesë të buxheteve të përcaktuara për barazinë gjinore në nivel lokal. Ndërsa është pozitiv fakti që Bashkia Fier ka një numër të lartë të grave të arsimuara në nivel Qarku dhe Bashkie dhe është në rritje numri i grave në pozicione drejtuese dhe në Bashki dhe në sipërmarrjet private.

Gjithsesi shumë punë duhet akoma në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të grave për rolin e tyre në shoqëri, duke i orientuar drejt profesioneve dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje lokale.

Tabela 19. Numri i viktimave të dhunës në familje

NJ. ADM.	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
NJA. Nr.1	12	9	7
NJA nr.2	20	7	9
NJA nr.3	16	11	8
NJA nr.4	18	13	6
Qendër	3	8	7
Libofshë	5	11	10
Topojë	2	3	6
Mbrostar Ura	6	5	8
Dërmenas	3	7	11
Portëz	2	5	9
Levan	5	8	11
Frakull	1	8	6
Cakran	4	6	5
TOTALI	97	101	103

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

Përsa i përket numrit të viktimave të dhunës në familje, ka një rritje krahasuar me periudhën 2016-2018 si pasojë e një sërë faktorësh që lidhen me: migracionin, xhelozinë, nivelin e ulët arsimor, konsiderimin e dhunës si diçka personale, etj. Aktualisht rezulton që ka një numër relativisht të lartë të numrit të Urdhrave të Mbrojtjes dhe kjo kërkon një koordinim dhe specializim të të gjithë stafit në të gjitha institucionet e përfshira për trajtimin e problematikës që lidhet me dhunën në familje, ndërsa mungojnë programet e rehabilitimit lokal. Ky shërbim i munguar është realizuar në bashkëpunim me qendrën "Vatra" në Vlorë dhe Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Gjithashtu një shërbim i munguar në Bashkinë e Fierit janë edhe bonuset e qerasë, mbështetje të cilën Bashkia Fier e ka siguruar nëpërmjet bashkëpunimit me Shoqatën "Të ndryshëm, por të barabartë", me mbështetje qiraje për 3 muaj me të drejtë shtyrje, për viktimat e dhunës në familje.

Fieri është një nga Bashkitë e evidentuara me numrin më të madh të rasteve të dhunës në familje, megjithatë Bashkia Fier nuk ka një Strehëz 72 orëshe për rastet e dhunës në familje dhe kjo është një nevojë imediate. Në Bashkinë Fier kemi disa raste të shërbimeve ndër-disiplinore që ofrohen ose përmes kontraktimit të OJF-ve të specializuara, ose përmes juristëve, psikologëve dhe punonjësve socialë, ndërsa rezulton që personeli mjekësor i DSHP-së është i mirë-trajnuar lidhur me çështjet e barazisë gjinore. Sfidat për të ardhmen janë si më poshtë:

- Hartimi dhe zbatimi i programeve të edukimit/ sensibilizimi për mbrojtjen e personalitetit dhe individualitetit të grave në tërësi;
- Vlerësimi i situatës;
- Ngritja një qendre për këshillimin dhe mbështetjen e grave dhe vajzave të dhunuara;
- Ngritja e një Qendre 72 – orëshe për rastet e emergjencave;
- Hartimi i politikave lokale për dhënien përparësi për punësim të grave të divorcuara.

Për sa i përket viktimave të trafikimit duhet vënë theksi mbi:

- Krijimin e shërbimeve për parandalimin e fenomenit dhe zgjidhjen e problemeve ekonomike të grave e vajzave;
- Hartimin dhe zbatimin e programeve parandaluese për sensibilizimin e grave, vajzave e të familjeve të tyre;
- Ri-integrimin përmes strukturave të shërbimeve sociale: Qendra për rehabilitimin e viktimave të trafikut; Programe të nxitjes së punësimit për personat e trafikuar, etj.

Në vitin 2018 falë një bashkëpunimi të suksesshëm me qendrën Sociale "Murialdo" Bashkia Fier ka bashkëpunuar në projektin Cause, mbështetur nga Partners Albania për ngritjen e bizneseve sociale duke shfrytëzuar pronat e konfiskuara të mafias. Nga NJBGJDFH janë orientuar rreth 23 gra, viktimat e dhunës në familje, të pajisura ose jo me Urdhër Mbrojtje, për formim profesional në fushën e pastitçerisë. 5 prej tyre janë punësuar në këtë biznes.

5.6 Të moshuarit e vetmuar

Në vitin 2007, në kuadrin reformës dhe decentralizimit të shërbimeve sociale, është bërë kalimi zyrtar i *Shtëpisë së të Moshuarve* në varësi të Bashkisë së Fierit. Ky kalim është shoqëruar me një vlerësim fizik të institucionit dhe me një vlerësim të shërbimeve të ofruara. Nga vlerësimi rezultoi se “Shtëpia e të moshuarve” ka nevojë si për një përmirësim të strukturës së ndërtesës, për ta bërë atë të përshtatshme për moshën e tretë, ashtu edhe për pajisjen e saj me mjetet e nevojshme, siç janë karriget me rrota, krevate të përshtatshëm për persona me aftësi të kufizuar, karriget dhe mbajtëset e dushit etj.

Tabela 20. Shërbimet e përkuqjesit për moshën e tretë si më poshtë:

Emërtimi Qendrës/OJF-së	Rezidenciale	Publike	Jo publike	Kapaciteti Max	Kapaciteti aktual	Mosha
Shtëpia e të moshuarve Fier	po	po		60	53	+65

Burimi i informacionit: Bashkia Fier

Deri më sot janë bërë disa ndërhyrje të pjesshme me ndihmën e bizneseve për të rikonstruktuar ambiente të veçanta, por gjithmonë ka patur dhe ka nevoja për rikonstrukcion të godinës dhe pajisjen e saj, me qëllim që të sigurohen standardet e shërbimit.

Shtëpia ofron shërbim 24 orë dhe ka nevojë për kujdes shëndetësor dhe jo vetëm rezidencial. Sugjerohet ndryshim i statusit të Shtëpisë, pasi ofrohen edhe shërbime shëndetësore për personat në gjendje të vështirë.

Pranimi në Shtëpinë e të Moshuarve bëhet me vendim të Këshillit Bashkiak, sipas kriterëve të përcaktuara dhe të publikuara dhe nga Shërbimi Social Shtetëror, i cili bën komisionimin e personave që pranohen në rezidencë.

Risi për vitin 2018 është marrja me qera e një ambienti në fshatin Topojë, për ndërtimin e një qendre ditore për të moshuarit. Gjithashtu, për këtë grup shoqëror, Bashkia ofron edhe një Qendër Ditore të hapur, ku ofrohen shërbime rekreacioni dhe kujdesi.

Referuar Planit Lokal të Zhvillimit dhe nevojave të artikuluara nga grupet e interesit gjatë procesit të hartimit të PKS-se, sfidat për të ardhmen për sa i përket moshës së tretë janë:

- Shtimi i shërbimeve të reja sociale;
- Ngritja e qendrave ditore për të moshuarit në të gjithë territorin e bashkisë;
- Akses të barabartë në shërbime shëndetësore;
- Mbështetje për mjekimin e sëmundjeve kronike e profesionale;
- Shërbime ditore në familje në përputhje me gjendjen e tyre sociale, fizike e psikologjike.

5.7 Komunitetet

Në Fier banon një komunitet i madh i popullsisë Rome, pjesa më e madhe e të cilëve banon në zonën sub-urbane të qytetit të Fierit.

Duke ju referuar Planit Lokal të Veprimit për Komunitetin Rom dhe Egjiptiane (R&E), në Bashkinë Fier raportohet të ketë një popullsi R&E prej rreth 3,650 persona, ose ndryshe, rreth 730 familje. Shumica e tyre janë të vendosura në Levan dhe Drizë (me rreth 250 familje në secilën prej këtyre zonave) duke

u ndjekur nga Baltëza (100 familje), Mbrostar (70 familje) dhe Fermë, "Afrim i Ri" dhe Sektor (me nga rreth 30 familje secila). Gjithsesi, si edhe në zona të tjera, shifra të sakta dhe zyrtare është e vështirë të gjenden. Pjesa më e madhe e këtyre familjeve jetojnë në kushte shumë të vështira social-ekonomike, dhe një pjesë e konsiderueshme, nuk plotësojnë as kushtet minimale të jetesës.

Tabela 21. Popullsia dhe numri i familjeve Rome sipas njësive administrative (2015)

Njësiti administrative	Popullsia Rome	Numri i familjeve
Fier		
Qendër Fier	1,760	352
Libofshë		
Topojë	121	24
Mbrostar	450	80
Dermenas	900	285
Portëz		
Levan	1,000	270
Frakull		
Cakran		
TOTALI	4,231	1,011

Burimi i informacionit: Plani Lokal i Veprimit për Komunitetin R&E në Bashkinë Fier

Të dhënat janë një çështje problematike për komunitetin R&E. Kështu, ndërsa ka të dhëna për fëmijët që janë të përfshirë/regjistruar në sistemin arsimor, nuk gjenden të dhëna për ata që mund të jenë jashtë sistemit. Për fëmijët 3 deri në 5 vjeç, rezultoi se rreth 122 prej tyre shkojnë në institucione të arsimit parashkollor (më konkretisht – 2 në Sektor Seman, 39 fëmijë në Baltëz, 44 në Levan, 16 në Drizë, 9 në Fermë "Afrim i Ri" dhe 12 në Mbrostar)¹⁸.

Vështirësitë ekonomike (të manifestuara në mungesë ushqimi dhe veshmbathje) i dekurajojnë familjet R&E t'i dërgojnë fëmijët e vegjël në kopësht. Një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon vendimmarrjen e familjeve në këtë drejtim është edhe distanca e objekteve dhe aksesit në transport. Niveli i ulët i punësimit (veçanërisht tek gratë R&E) shton listën e faktorëve që në mënyrë racionale i bën shumë familje R&E të presin vitet e detyruara të shkollimit për t'i vënë fëmijët e tyre në kontakt me këto institucione.

Për vitin akademik 2018-2019, në Bashkinë Fier, arsimin e detyrueshëm e ndjekin mbi 300 fëmijë R&E. Në raport me popullsinë, numrin më të madh të fëmijëve R/E, që ndjekin shkollën, e ka Levani me 109 nxënës, dhe më pas zonat e tjera, Drizë 80 nxënës, Baltëz 75 nxënës, Mbrostar 30 nxënës, Fermë "Afrim i Ri" 14nxënës dhe Sektor 10 nxënës. Edhe në arsimin e detyruar, pjesëmarrja dhe frekuentimi mbeten në nivele të ulta, pasi arsyet ekonomike, lëvizjet e shpeshta migratore (brenda dhe jashtë vendit) kombinuar edhe me çështje të mentalitetit, i pengojnë fëmijët R&E të ndjekin (rregullisht) shkollën dhe të performojnë mirë. Mentaliteti ndëshkon në mënyrë të veçantë vajzat R&E, të cilat nga presioni i familjes, e ndërpresin shkollimin rreth moshës së pubertetit dhe janë të orientuara për martesë të hershme.

Për vitin akademik 2018-2019, raportohet se rreth 50 fëmijë të moshës 6-15 vjeç e kanë braktisur shkollën. Pra rreth 15% e fëmijëve R&E në moshë arsimit të detyrueshëm, janë momentalisht jashtë sistemit.

Përtej arsyeve të listuara më sipër, pengesë për frekuentimin e shkollës bëhet edhe infrastruktura dhe aksesit i ulët që këto komunitete kanë në institucionet e arsimit.¹⁹

¹⁸ Plani Lokal i Veprimit për Komunitetin Rom dhe egjiptian në Bashkinë Fier,

¹⁹ Plani Lokal i Veprimit për Komunitetin Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Fier,

Gjithashtu niveli i të ardhurave është tërësisht i pamjaftueshëm për familjet e tyre. Rreth 21% e familjeve Rome përfitojnë ndihmë ekonomike me statusin e familjes pa ta ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

Numri i komunitetit Rom që ka përfituar nga kurset e formimit profesional pa pagese, është shumë i vogël. Në 2014-2015 vetëm 6 anëtarë të komunitetit rom kanë ndjekur kurse të formimit profesional. Ky numër i ulët i përfituesve nga kurset lidhet me pamundësinë e këtij komuniteti për të mbuluar koston e transportit nga vendbanimi i tyre në Qendrën e Aftësisimit Profesional në Fier si dhe mungesa e besimit se do të gjejnë një punë pas përfundimit të kursit.

Ndonëse niveli i punësimit dhe papunësisë për minoritetin R&E në Fier është e pamundur të përcaktohet me të dhënat në dispozicion, nga Zyra e Punës raportohet se për vitin 2018, janë regjistruar si punëkërkuar të papunë rreth 235 romë dhe egjiptianë, nga të cilët është arritur të punësohen 30 prej tyre (ose rreth 13%). Këta individë janë punësuar kryesisht në sektorin e fasonerisë, i cili është edhe sektori kryesor i punësimit formal të R&E. Pjesa më e madhe e minoritetit R&E në Fier e siguron jetesën me aktivitete prodhuese/ekonomike në bujqësi, blegtori, tregti dhe ndërtim. Gjithashtu, duke ruajtur traditat dhe shfrytëzuar talentin, disa R&E janë aktivë edhe si muzikantë²⁰.

Problematikat e strehimit shtrihen që nga mungesa totale e tij e deri tek kushtet e këqija të banesës, apo tek banesa të ngritura në mënyrë jo të ligjshme. Objektet e ndërtuara pa leje janë një fenomen në thuajse të gjitha zonat/vendbanimet me përqendrim R&E. Megjithatë ka vonesa ose vështirësi të lidhura me informimin nga ZVRPP për procedurat që duhen ndjekur, si dhe me faktin që një pjesë e objekteve nuk janë të qëndrueshme për t'u kualifikuar për regjistrim. Familje të veçanta kanë problematika me banesat e tyre, të cilat i kanë çuar në procese gjyqësore, të cilat kanë vështirësi të ndjekin²¹.

Përveç problematikave me banesat dhe regjistrimin e tyre, familjet R&E përballen në vazhdimësi me vështirësi për të përballuar kostot e shërbimeve për një jetesë me dinjitet, si uji i pijshëm dhe energjia elektrike. Gjendja e vështirë ekonomike pengon, si lidhjen e kontratave, ashtu edhe përballimin e kostove të shërbimeve në vijimësi.

Një kategori tjetër familjesh, veçanërisht në Levan, kanë ngritur shqetësimin e pronave të tjetërsuara, një çështje që kërkon angazhim dhe asistencë juridike për t'u ndjekur. Mungesa e dokumentacionit për të vërtetuar pronësinë e tokave të ndara sipas ligjit nr. 7501 është kthyer në një kufizim serioz për mirëqenien e këtyre banorëve ashtu si edhe për mundësitë për ta zhvilluar pronën më tej apo përdorur atë si aset, kolateral për kredi të mundshme, etj.

Në Mbrostar ka edhe tri problematika të tjera specifike, që kërkojnë adresim. Së pari, banesat e komunitetit R&E janë të vendosura pranë hekurudhës dhe, ndonëse lëvizjet e trenave janë shumë të rralla, duhet të adresohen çështjet e sigurisë. Së dyti, disa banesa, të ndërtuara pas viteve '90-të në atë zonë, kanë shkaktuar ndotje serioze të mjedisit për një pjesë të familjeve Rome. Këto banesa nuk kanë as kanalizim të ujërave të zeza dhe as gropa septike, duke lënë ujërat e zeza të rrjedhin drejt banesave Rome, që janë në disnivel kundrejt tyre. Së treti, familjet Rome në këtë zonë vuajnë mungesën e ujit të pijshëm/rrjedhshëm. Kjo problematikë është adresuar deri tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ndonëse janë marrë masa ndëshkimore (si për shembull gjobitja e Bashkisë Fier), problemi mbetet i pazgjidhur. Banorët janë të gatshëm të pranojnë edhe zgjidhje të përkohshme/transitore deri në zgjidhjen përfundimtare të problemit (p.sh furnizimi i përkohshëm me ujë përmes autoboteve).

Programet e strehimit, të cilat kanë ndihmuar (ndër të tjera) me rehabilitimin e banesave të minoriteteve R&E, kanë përmirësuar kushtet e strehimit për një numër të konsiderueshëm banorësh. Megjithatë, ka ende nevoja të mëdha të pa adresuara, ku problemi më i madh është pamundësia për përfitim/ndërhjërje në banesa të paqëndrueshme (kasolle) dhe ato pa dokumentacion. Për më tepër, familjet R&E e kanë thuajse të pamundur të përfitojnë nga programet e strehimit që ofrojnë mundësinë e kredive të buta, pasi punësimi i tyre është i parregullt dhe jo-formal.

20 Plani Lokal i Veprimtimit për Komunitetin Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Fier,

21 Plani Vendor i Vlerësimit të Nevojave, Analizë e Prioritete për Skemën e Ndihmës së Shërbimeve Shoqërore, Bashkia Fier.

Në mënyrë sporadike, R&E janë targetuar nga nisma të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile për t'u ndërgjegjësuar lidhur me çështjet e shëndetit të mirë dhe aksesit në shërbimet shëndetësore. Në përgjithësi, minoriteti R&E është i regjistruar me një mjek familjeje dhe pjesa më e madhe e tyre zotërojnë karta shëndeti. Pavarësisht kësaj, aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor është relativisht i ulët si pasojë e mungesës së kontributeve në skemën e sigurimeve shëndetësore.

Çështjet kryesore të komunitetit R&E dhe fushat prioritare të ndërhyrjes janë përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Integrimin Rom dhe Egjiptian në Shqipëri (2015-2020) dhe në Planin Vendor për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2019-2022.

Për specifikat që ka komuniteti në Bashkinë e Fierit, në Planin Lokal të Veprimit për Komunitetin R&E, janë përcaktuar si fusha prioritare :

- arsimi;
- punësimi dhe fuqizimi ekonomik;
- kujdesit shëndetësor;
- strehimi dhe infrastruktura e vendbanimeve;
- mundësi të barabarta dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore.

Në ndihmë të komunitetit R&E janë hapur 2 Qendra Komunitare.

1. Qendra Komunitare Multifunkionale Levan, ku marrin shërbime rreth 250 individë (fëmijë, prindër, të moshuar). Këto shërbime konsistojnë në:

- sesione informuese;
- takime sensibilizuese;
- këshillime psikologjike;
- shërbimi 'after school';
- aktivitete argëtuese;
- lojëra psiko - sociale.

2. Qendra Komunitare Lëvizëse Drizë ku marrin shërbime rreth 200 individë.

Takimet bëhen në bazë grup-moshe, si për fëmijët dhe për prindërit, punohet që të sigurohet pjesëmarrje e të dy gjinive. Këto qendra vijnë në ndihmë të komunitetit për integrimin e tyre në jetën shoqërore.

Së fundmi është duke u hapur edhe një Qendër tjetër komunitare tek banesat Sociale në bashkëpunim me organizatën Terres des Hommes, ku do të ofrohen shërbime kryesisht për komunitetin vulnerabël që jeton në këtë zonë dhe jo vetëm.

Gjithashtu në Baltëz, në ndihmë të komunitetit Rom ka ardhur hapja e një magazine për grumbullimin e bimëve medicinale ku individët të cilët duan të sigurojnë të ardhura, mbledhin bimë medicinale dhe i çojnë në këtë pikë grumbullimi, duke rritur kështu ekonominë e tyre familjare. Kjo iniciativë është realizuar në kuadër të projektit që Fondacioni "Ndihmë për Fëmijët" po zbaton "Shërbime Sociale të Integruara për Zhvillim të Qëndrueshëm Shoqëror dhe Ekonomik të Romëve dhe egjiptianëve" në kuadër të programit "Askush të Mos Mbetet Pas", i zbatuar nga UN në Shqipëri, financuar nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri dhe nën mbikëqyrjen e UNDP Shqipëri.

Gjithashtu familjeve të komunitetit Rom me anë të projektit të Terres des Hommes i është ofruar ndihma me anë të IGA-ve për fuqizimin ekonomik të familjeve.

5.8 Të rinjtë në rrezik

Në Fier, ekziston Zyra e Shërbimit të Provës, e cila bashkëpunon me Bashkinë Fier, për të krijuar hapësira dhe mundësi për të rinjtë në konflikt me ligjin, më qëllim ri-integrimin e tyre në shoqëri. Në 2019, pranë ambienteve të Qendrës Multifunkionale Fier, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Fier me Ministrinë e Drejtësisë "Për sigurimin e kuadrit infrastrukturor dhe institucional për zbatimin e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale për të miturit në konflikt me ligjin", është vënë në dispozicion një ambient zyre, ku të rinjtë përveç ofrimit të mundësisë së kryerjes së punëve në komunitet marrin edhe shërbimin e terapisë psikologjike, përmes një psikologu që Bashkia ka angazhuar për këtë qëllim.

Për sa i përket të rinjve të rrezikuar nga droga, alkooli dhe duhani mbetet prioritet:

- Krijimi i qendrave kulturore-rinore për argëtim cilësor dhe profesional;
- Programet për nxitjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes;
- Qendra detoksifikuese për personat në varësi të alkoolit e drogës, këshillim e mbështetje psiko-sociale;
- Shërbime alternative në mjedis familjar;
- Hartimi i një Plani sektorial për Rininë.

Në këtë kuadër vlen të përmendet puna e bërë nga Qendra Epoka e Re, e cila është aktive në Fier në fushën e ofrimit të shërbimeve për të rinjtë e moshës 14-29 vjeç. Kjo Qendër përveç disa programeve dhe shërbimeve që ofron për të rinjtë, është e vetmja Qendër në Fier ku të rinjtë kanë mundësi të zhvillojnë aktivitete argëtuese, krijuese edhe edukuese.

5.9 Analiza SWOT, Sfida dhe nevoja për ndërhyrje në të ardhmen

Fieri është një nga zonat me potenciale zhvillimi ekonomik dhe social nga më të favorshmet në Shqipëri, për arsye të avantazheve ekonomike të qytetit dhe zonës në tërësi. Shfrytëzimi i këtij potenciali ekonomik në bazë të politikave vendore është i rëndësishëm për zhvillimin social, për të mundësuar që të jetë gjithëpërfshirës. Analiza e të dhënave social-ekonomike si dhe treguesit mbi vulnerabilitetin, tregojnë se ka vend për politika sociale vendore të kujdesshme për të arritur pikërisht ato grupe që janë më në nevojë. Duke patur parasysh këtë gjë, nëpërmjet metodologjisë së ndjekur për hartimin e Planit të Kujdesit Social 2019-2023, siguroam zërin e grupeve të interesit në përcaktimin e prioriteteve dhe masave për përfshirjen sociale të tyre.

Në kushtet e burimeve të kufizuara financiare të Bashkisë, analiza SWOT e realizuar me grupet e interesit siguron ndërtimin e një plan veprimi me konsensusin e të gjithë aktorëve. SWOT mundëson gjithashtu marrjen e një pozicioni të qartë rreth aftësive dhe mundësive që bashkia ka aktualisht si edhe rreth mundësive për të përmirësuar kapacitetet institucionale, materiale dhe njerëzore.

Tabela 21. Analiza SWOT

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
<ul style="list-style-type: none"> • Një Bashki me potenciale ekonomike të mëdha dhe burime natyrore avantazhuese krahasuar me qytete të tjera. • Popullsi relativisht e re dhe me arsimim të mirë. • Popullsi me karakteristika shumë të mira të kohezionit social. • Një bashkëpunim shumë i mirë institucional midis nivelit qendror dhe lokal. • Staf i përkushtuar dhe i dedikuar në ofrimin e shërbimeve. • Një numër i konsiderueshëm specialistësh të trajnuar për ofrimin e shërbimeve sociale duke adresuar grupe të veçanta. • Organizata të shoqërisë civile dhe shoqata aktive në mbrojtje të të drejtave të njeriut. • Bashkia një institucion me potenciale ekonomike dhe njerëzore të përshtatshme për të ofruar shërbime cilësore. • Infrastruktura e përshtatshme arsimore e shëndetësore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli i lartë i papunësisë tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi ndryshe. • Shkalla e lartë e emigracionit jashtë vendit. • Politikat sociale lokale deri diku të munguara të Bashkisë së Fierit për përfshirjen sociale të grupeve të veçanta siç janë Romët, Egjiptianët dhe personat me aftësi ndryshe. • Mungesa e shërbimeve të integruara. • Sipërfaqe e madhe dhe terren i shtrire në zona rurale. • Grupet e interesit nuk janë të mirë-organizuar dhe kompakte në prezantimin e problemeve të tyre. • Mungesa e të dhënave të sakta dhe të besueshme, për të bërë politika vendore bazuar në evidenca.
MUNDËSITË	RREZIQET
<ul style="list-style-type: none"> • Angazhim i pushtetit vendor në Bashkinë e Fierit për respektimin e traditës dhe të drejtave të njeriut. • Bashkia Fierit dhe stafi është i angazhuar për të bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtarë. • Angazhimi i organizatave partnere për të ndihmuar komunitetin dhe Bashkinë e Fierit për të ngritur shërbime për grupet në nevojë (UNDP). • Disa prej reformave të ndërmarra në vend adresojnë grupet e përjashtuara, (reforma kundër informalitetit, reforma e ndihmës ekonomike, reforma e pensioneve, reforma arsimore, etj.) • Reforma territoriale dhe Ligji i ri 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” zgjeron hapësirën e pushtetit vendor për përfshirjen sociale të grupeve të përjashtuara 	<ul style="list-style-type: none"> • Reforma territoriale dhe zgjerimi i hapësirës territoriale të funksionimit të pushtetit vendor të Bashkisë së Fierit, ka bërë që shumë nga problemet sociale ekonomike të popullatës që kanë qenë jashtë territorit të Bashkisë, të mos njihen dhe për rrjedhojë të neglizhohen. • Shkatërrimi i industrisë ekzistuese, për pasojë rritja e papunësisë në grupmoshat e reja. • Lëvizjet migratore brenda dhe jashtë vendit gjatë 20 viteve të fundit. • Legjislacioni në ndryshim të vazhdueshëm. • Ndryshimi i stafit të bashkisë (pothuajse çdo katër vjet). • Mungesa e disa shërbimeve të cilat janë shumë të kushtueshme siç janë shërbimet emergjente 24 orëshe.

5.9.1 Përmirësime në Strukturën e Shërbimit Social

- Ngritja e kapaciteteve dhe shtimi i stafit të Njësive të Nevojave dhe e Referimit të Rasteve (NjVRR) në Bashki;
- Ngritja e NJMF në NJA (9 punonjës social);
- Ngritja e Zyrës së Statistikave në Bashki;
- Ngritje e kapaciteteve të stafit për ofrimin e shërbimeve të integruara dhe multifunkionale;
- Trajnim i vazhduar për stafin e bashkisë dhe për stafin e qendrave mbi ofrimin e shërbimeve të specializuara rehabilituese dhe integruese përmes trajnimeve formale dhe shkëmbimit të eksperiencave me qendra të tjera;
- Trajnim i stafit të shërbimeve sociale në bashki dhe njësi administrative mbi qasjet bashkëkohore ndaj personave me aftësi të kufizuara.

5.9.2 Përmirësimi dhe Ngritja e Shërbimeve të Reja të Përkujdesit Shoqëror

- Ngritja e shërbimeve komunitare për çdo NJA;
- Ngritja e Shërbimit të emergjencës 72 orësh;
- Mirëmbajtje e shërbimit ekzistues (terapi zhvillimi, terapi te foluri, fizike, okupacionale në grup dhe individuale) , etj;
- Zgjerim i shërbimeve ekzistuese me shërbime të reja (staf profesional për shërbim në familje) dhe fuqizim i punës me prindërit/ familjen;
- Ofrimi i shërbimit të diagnostikimit të hershëm;
- Sigurim i transportit (të përshtatur) për fëmijët që banojnë jashtë qytetit dhe i karrigeve me rrota për ata që kanë nevojë;
- Forcim i bashkëpunimit me shkollat (institucionet e sistemit parauniversitar: kopshte, shkolla) dhe ofrues të tjerë publike e jopublike shërbimesh);
- Identifikim i hershëm i fëmijëve me AK;
- Shërbime për jetesë të pavarur dhe shërbime referimi;
- Grumbullim i statistikave për moshën e tretë, për dhunën në familje, për personat me aftësi të kufizuara sipas llojit të aftësisë së kufizuar (fizike, shqisore, intelektuale, mendore), moshës, gjinisë, arsimit/formimit/punësimit, vendbanimit, gjendjes ekonomike, nevojave për mbështetje; analiza e të dhënave dhe rishikimi i ndërhyrjeve të planifikuara;
- Përfshirje e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara gjatë konceptimit, planifikimit, buxhetimit dhe monitorimit të shërbimeve për ta;
- Monitorim nga Bashkia i shërbimeve të ofruara përmes kontrollit e vizitave, aty ku ofrohen shërbimet si dhe përmes anketave të përdoruesve të shërbimeve mbi pa/kënaqësinë e tyre;
- Përmirësimi i situatës arsimore të minoriteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Fier;
- Fuqizimi ekonomik i minoriteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Fier, përmes integritit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve për kualifikim, punësim dhe programeve të mbrojtjes sociale;
- Përmirësimi i gjendjes së strehimit të minoriteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Fier, përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme;
- Përmirësimi i shëndetit dhe aksesit në shërbimet shëndetësore për anëtarët e minoriteteve Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Fier;
- Ri-integrimi i familjeve Rome dhe Egjiptiane të kthyer nga emigrimi.

6. PËRCAKTIMI I VIZIONIT, FUSHAVE, QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË PKS-SË

Vizioni i Bashkisë Fieri mbi mirëqenien sociale të komunitetit është hartuar në mënyrë organike, rezultat i gjetjeve të analizës të bërë në pjesën e parë të këtij dokumenti mbi situatën social ekonomike të popullsisë, që jeton në këtë bashki, e kombinuar me diskutimet e bëra me qytetarët, takimet me grupet e interesit dhe reflektimet e grupit të punës gjatë hartimit të PKS-së.

Bashkia e Fierit do të sigurojë që çdo individ, familje dhe komunitet në nevojë, të marrë shërbime të përshtatshme dhe sipas standardeve. Gjithashtu komuniteti i Fierit do të tregojë se është solidar me kategoritë e popullatës me nevoja të veçanta sociale.

Po mbi këto baza, pjesëmarrësit në këto diskutime, nën drejtimin e grupit të punës, kanë rënë dakord në formulimin e fushave të ndërhyrjes, qëllimeve dhe objektivave specifike, si më poshtë:

FUSHA 1: KOORDINIMI DHE RRJETËZIMI I SHËRBIMEVE

Qëllimi 1. Rritja e bashkëveprimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve për të siguruar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve sipas nevojave në të gjithë territorin e Bashkisë Fier.

Objektivi 1.1: Të ndërtojmë një sistem të qëndrueshëm dhe të standardizuar informacioni mbi nevojat për shërbime dhe ofruesit e shërbimeve.

Aktivitetet:

1. Krijimi i hartës së shërbimeve në territorin e Bashkisë Fier, duke përfshirë partnerët dhe operatorët (publik dhe privat);
2. Krijimi i shportës bazë të shërbimeve shoqërore, përfshirë disa tregues që ndihmojnë popullatën të marrë shërbimin më të përshtatshëm dhe më të arritshëm;
3. Krijimi i hartës së vulnerabilitetit. Një studim i thelluar i nevojave për shërbime të kujdesit social për të gjitha grupet në rrezik, në bashkëpunim me organizatat dhe operatorët që veprojnë në territor;
4. Krijimi i një baze të dhënash për individët/ familjet dhe grupet, përfitues të shërbimeve dhe ndarja e të dhënave me operatorët/ organizatat që ofrojnë shërbime në terren. Popullimi me të dhëna i Regjistrit Elektronik Kombëtar;
5. Vendosja e një linje telefonike në Bashki në përgjigje të rasteve emergjente.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, NJA, OJF-të, Donatorët, Ministria përkatëse.

FUSHA 2: STRUKTURAT DHE BURIMET NJERZORE

Qëllimi 2. Fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe njerëzore të shërbimeve sociale.

Objektivi 2.1: Ngritja e mekanizmave dhe kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social sipas nevojave në të gjithë territorin e bashkisë Fier.

Aktivitetet:

1. Ngritja e kapaciteteve e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashki, duke fuqizuar strukturën me një punonjës social;
2. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi për strukturën;
3. Plotësimi i strukturës së NJA-ve me staf mbështetës (9 punonjës social) që të mbulojnë të gjitha target grupet;
4. Organizimi i takimeve periodike për forcimin e rrjetit të shërbimeve në nivel vendor;
5. Fuqizimi i strukturës së NjVRR në Bashki dhe në njësite administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime;
6. Hartimi i një formati standard për menaxhimin e rasteve.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat

Objektivi 2.2: Të hartojmë mekanizmat për fuqizimin e strukturave të Bashkisë për vlerësimin e nevojave, financimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve që ofrohen nga operatorët që veprojnë në territorin e Bashkisë.

Aktivitetet:

1. Hartimi i planit të punës së funksionimit të NjVRR;
2. Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të nevojave;
3. Hartimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit;
4. Krijimi dhe administrimi i Fondit Social në Bashki, mbështetur nga burimet e veta të bashkisë (paraqitja në buxhetin e vitit 2020);
5. Trajnimi i stafit (punonjësit e shërbimeve sociale) të Bashkisë mbi rolin dhe përgjegjësitë që përcakton ligji nr.121/2016.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria.

Objektivi 2.3: Të rriten kapacitetet e stafeve të strukturave të Shërbimit social në Bashki dhe Njësitë Administrative.

Aktivitetet:

1. Trajnime për procedurën që do të ndiqet për NjVRR;
2. Trajnime për rritjen profesionale të punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, për planifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e shërbimeve në territor;
3. Të fuqizohet struktura e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, dhe krijimi i rekordeve dhe statistikave vendore mbi individët dhe familjet me nevoja për shërbime sociale.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria.

FUSHA 3: SHËRBIMET SOCIALE NË BASHKINË FIER

Qëllimi 3. Përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë së Fierit.

Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Aktivitetet:

1. Ngritja e një qendre ditore për gratë dhe fëmijët në nevojë në Bashkinë Fier;
2. Hartimi i modelit të shërbimeve te integruara;
3. Sigurimi e funksionimi i qendrës, (mbështetja me staf dhe buxhet);
4. Ngritja e qendrave komunitare në çdo njësi administrative.

Aktorët përgjegjës: DSHS në Bashki, ASHDMF, DRSHSSH, NJA, donatorët dhe OJF-te

Objektivi 3.2: Të sigurohet fuqizimi i grave me probleme sociale dhe viktimave të dhunës me bazë gjinore.

Aktivitetet:

